



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 66, datë 11.11.2025



PËR MIRATIMIN E UDHËZUESIT PËR MËNYRËN E APLIKIMIT “PËR IMPLEMENTIMIN E SKEMËS: GRANTE PËR TË RINJTË NË MBËSHTETJE TË ZHVILLIMIT TË INICIATIVAVE EKONOMIKE LOKALE”

Në zbatim të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr. 9374, datë 21.04.2005 “Për Ndhimën Shtetërore” i ndryshuar, Ligjit Nr. 36/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 25/2022, “Për mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.605, datë 31.08.2016 “Për përcaktimin e vlerës maksimale, të kushteve dhe të procedurës për dhënien e ndihmës “de minimis”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 115, datë 24.12.2024 “Për miratimin buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025 dhe Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027”, shkresës së Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Drejtorisë së Përgjithshme të Nxitjes së Biznesit nr.7875 prot., datë 12.06.2025, protokolluar me tonën nr. 1975/2 prot., datë 16.06.2025 si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Turizmit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin e Udhëzuesit për mënyrën e aplikimit “Për implementimin e skemës: Grante për të rinjtë në mbështetje të zhvillimit të iniciativave ekonomike lokale”, bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Turizimit, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK Durrës

Denisa Luarasi



U shpall sot me datë 12.11.2025





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës

Udhëzues i Aplikimit

Për implementimin e skemës: “Grante për të rinjtë në mbështetje të zhvillimit të iniciativave ekonomike lokale”

Krijimi i një skeme garancie për bizneset inovative për të rinjtë,
nëpërmjet mbështetjes financiare me grante.



Durrës, Shtator 2025

Përmbajtja:

1. Hyrje
2. Qëllimi dhe objektivat
3. Përfitimet e një biznesi në sektorin e Mjedisit dhe Trashëgimisë Kulturore
4. Kush janë Përfituesit e Skemës
5. Buxheti

Udhëzuesi i Aplikimit

1. Çfarë është granti për bizneset në sektorin e Mjedisit dhe të Trashëgimisë Kulturore ?
2. Mbështetja financiare
3. Likuidimi i shpenzimeve
4. Aplikantët e pranueshëm
5. Shpenzimet që mund të mbulohen nga skema
6. Mbulimi Gjeografik
7. Strukturat e skemës së grantit dhe detyrat e tyre
8. Strukturat e monitorimit të skemës
9. Mënyra e procedimit të skemës së grantit
10. Kontraktimi i aplikanteve fitues dhe Përdorimi i ~~Fondeve~~
11. Monitorimi dhe Vlerësimi
12. Anekset



1. Hyrje

Zhvillimi i qëndrueshëm i territorit nuk mund të arrihet pa ruajtjen dhe vlerësimin e burimeve natyrore dhe trashëgimisë kulturore që një Bashki posedon. Në këtë kontekst, sektori i mjedisit dhe trashëgimisë kulturore përfaqëson një nga shtyllat kryesore për ndërtimin e një ekonomie të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe me identitet të fortë lokal. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në një periudhë kur komunitetet përballen me sfida të mëdha si pasojat e ndryshimeve klimatike, shpopullimi rural, humbja e traditave dhe presioni për zhvillim të paqëndrueshëm.

Burimet natyrore – si peisazhet, pyjet, uji, biodiversiteti dhe tokat bujqësore – janë asete të pazëvendësueshme që mund të krijojnë vlera të qëndrueshme ekonomike kur menaxhohen me kujdes dhe përfshirje komunitare. Nga ana tjetër, trashëgimia kulturore – si objektet historike, traditat, zejet, kulinaria, gjuha dhe ngjarjet komunitare – përbën bazën e identitetit tonë kolektiv dhe një potencial të madh për zhvillimin e turizmit, edukimit dhe inovacionit kulturor.

Në këtë ndërthurje midis ruajtjes dhe zhvillimit, është e domosdoshme që Bashkia Durrës të luajë një rol aktiv, jo vetëm si institucion planifikues e rregullator, por edhe si aktor nxitës i iniciativave që vijnë nga vetë komuniteti dhe sipërmarrja vendase. Prandaj, Bashkia Durrës ka hartuar një skemë mbështetjeje financiare në formën e granteve, me fokus të veçantë tek nismat që lidhen me mjedisin dhe trashëgiminë kulturore, duke synuar fuqizimin e atyre që kanë ide, pasion dhe kapacitete për të kontribuar në këtë drejtim.

Përmes kësaj thirrjeje, synohet të mbështeten të rinjtë, artizanë, organizatat e shoqërisë civile, të cilët kanë ide për krijim e bizneseve të reja ose zgjerimin e atyre ekzistuese, – të cilët mund të japin një kontribut konkret në:

- promovimin e turizmit të qëndrueshëm dhe agroturizmit,
- zhvillimin e produkteve tradicionale me vlerë të shtuar,
- inovacionin në teknologjitë mjedisore,
- edukimin dhe ndërgjegjësimin për çështje mjedisore dhe kulturore,
- mbrojtjen e pasurive të trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale,
- menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe peizazhit.

Ky udhëzues i aplikimit për grante është hartuar për të lehtësuar kuptimin e kriterëve, procedurave dhe prioriteteve të thirrjes, duke siguruar transparencë dhe gjithëpërfshirje në procesin e përzgjedhjes së projekteve që do të financohen.



2. Qëllimi dhe Objektivat

Qëllimi i kësaj skeme është të mbështesë nisma ekonomike dhe sociale që kontribuojnë në ruajtjen, promovimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve mjedisore dhe trashëgimisë kulturore. Përmes kësaj mbështetjeje synohet të nxiten modelet e biznesit të gjelbër, të inkurajohen praktikat tradicionale dhe inovative, dhe të krijohen mundësi të reja punësimi në përputhje me prioritetet strategjike të zhvillimit të qëndrueshëm vendor.

Kjo skemë e granteve për të rinjtë do të zbatohet nëpërmjet procedurës së aplikimeve me shprehje interesi, si një mundësi e re ekonomike për të rinjtë sipërmarrës aspirantë për të qenë të qëndrueshëm në një treg konkurrues. Ndihma jepet vetëm për të rinjtë që do të jenë fitues nga procesi i përzgjedhjes së aplikantëve me idetë më të mira dhe garantojnë qëndrueshmërinë e biznesit.

Qëllimi i kësaj thirrje është të mbështesë plane të qëndrueshme biznesi të ideuara nga të rinjtë e qytetit të Durrësit, për krijimin e bizneseve të reja ose zgjerimin e aktivitetit të bizneseve ekzistuese. Procesi i përzgjedhjes së aplikantëve ka si qëllim të ofrojë transparencë dhe konkurrencë të barabartë si dhe të mbështesë idetë dhe planet e biznesit më të mira, inovative, fitimprurëse dhe që garantojnë rezultate të qëndrueshme. Skema do të zbatohet në të gjithë territorin e Bashkisë Durrës.

Nëpërmjet implementimit të kësaj skeme për të rinjtë, synohet të promovojmë një model të qëndrueshëm të zhvillimit ekonomik, miqësor ndaj mjedisit si edhe një qasje alternative dhe inovatore ndaj trashëgimisë kulturore. Inovacioni apo risia konsiston në zbatimin e një produkti të ri, përmirësimin e ndjeshëm të shërbimeve ose proceseve, krijimin e një metode të re marketingu apo një metode të re organizative në praktikën e biznesit, me kushtin që veprimtaritë e propozuara të kenë një qasje miqësore ndaj mjedisit.



2.1 Objektivat Kryesore

1. **Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm lokal**, përmes mbështetjes së bizneseve që kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit dhe trashëgimisë kulturore.
2. **Përmirësimi i cilësisë së jetës** në komunitete përmes rritjes së ndërgjegjësimit dhe përfshirjes aktive të qytetarëve në aktivitete të lidhura me trashëgiminë dhe natyrën.
3. **Rritja e punësimit**, veçanërisht për të rinjtë dhe grupet në nevojë, nëpërmjet nxitjes së sipërmarrjes sociale dhe zhvillimit të aftësive të reja.

4. **Formalizimi dhe rritja e kapaciteteve të bizneseve të reja dhe ekzistuese**, që operojnë në fushën e artizanatit, kultures, turizmit të qëndrueshëm, agroturizmit dhe shërbimeve mjedisore.
5. **Promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe trashëgimisë kulturore**, në përputhje me politikat lokale dhe kombëtare për zhvillim të qëndrueshëm.
6. **Forcimi i partneriteteve midis sektorit publik dhe privat**, si dhe përfshirja e organizatave të shoqërisë civile në menaxhimin e resurseve mjedisore dhe kulturore.

3. Përfitimet e një biznesi në sektorin e Mjedisit dhe të Trashëgimisë Kulturore nga skema e Grantit

Përfitimet e një biznesi që operon në sektorin e Mjedisit dhe të Trashëgimisë Kulturore janë të shumëanshme, duke përfshirë jo vetëm aspektin ekonomik, por edhe atë shoqëror, mjedisor dhe kulturor.

3.1. Përfitime Ekonomike

- **Treg i qëndrueshëm dhe në rritje:** Kërkesa për produkte dhe shërbime alternative, të qëndrueshme dhe me identitet kulturor është në rritje, si në tregun vendas, ashtu edhe në atë ndërkombëtar.
- **Mundësi financimi dhe subvencionesh:** Bizneset në këtë sektor do të përfitojnë në aksesimin e granteve, të financuara nga buxheti i Bashkisë Durrës.
- **Diferencim në treg:** Produktet dhe shërbimet që lidhen me mjedisin ose trashëgiminë kanë vlerë të shtuar dhe krijojnë identitet të veçantë për konsumatorët lokal dhe turistët.
- **Turizëm me shpenzim të lartë:** Turistët që kërkojnë përvoja autentike kulturore apo natyrore kanë tendencë të shpenzojnë më shumë dhe të qëndrojnë më gjatë dhe kjo perkthehet në rritje ekonomike lokale.

3.2. Përfitime Sociale dhe Komunitare

- **Fuqizimi i komunitetit lokal:** Këto biznese do të krijojnë punësim për banorët, sidomos në zonat rurale, duke ndihmuar në frenimin e emigracionit dhe shpopullimit.
- **Ruajtja e identitetit lokal:** Bizneset që ruajnë zëjet tradicionale, gjuhën, muzikën, gatimet apo elementë të trashëgimisë ndihmojnë në forcimin e lidhjes së komunitetit me rrënjët e tij.

- **Përfshirja e grupeve të marxhinalizuara:** Shumë projekte të suksesshme në këtë sektor do të përfshijnë gra, të rinj, apo persona me aftësi ndryshe duke kontribuar në barazi sociale.

3.3.Përfitime Mjedisore

- **Menaxhim i qëndrueshëm i burimeve natyrore:** Ndryshe nga modelet konvencionale të biznesit, këto biznese kanë mundësinë që të aplikojnë për praktika që ruajnë natyrën dhe biodiversitetin.
- **Zvogëlim i ndotjes dhe mbetjeve:** Përdorimi i materialeve të riciklueshme, ekonomia qarkulluese dhe efikasiteti energjetik janë të zakonshme në këtë sektor.
- **Ndërgjegjësim dhe edukim mjedisor:** Bizneset ekologjike kanë një rol aktiv në edukimin e konsumatorëve dhe komuniteteve për çështje mjedisore.

3.4.Përfitime Kulturore dhe Edukative

- **Ruajtje dhe promovim i trashëgimisë:** Bizneset do të promovojnë traditën, zeje, receta dhe zakone që janë pjesë e identitetit local dhe kombëtar.
- **Krijim përvojash edukative:** Shumë prej këtyre nismave përfshijnë guida, punëtori, muze lokalë apo aktivitete që lidhen me historinë dhe kulturën e një zone.
- **Zhvillim i diplomacisë kulturore dhe imazhit të vendit:** Përmes përfshirjes këto biznese do të ndihmojnë në trasmetimin e një imazhi pozitiv për vendin dhe qytetin e Durrësit.

4. Kush janë përfituesit e skemës

Skema e granteve është e hapur për individë dhe organizata të shoqërisë civile që kanë një ide për krijimin e një biznesi të ri ose zgjerimin e atyre ekzistuese që kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm përmes ruajtjes së mjedisit dhe promovimit të trashëgimisë kulturore. Kategoritë e përfituesve përfshijnë:



4.1.Të rinj individë dhe Organizata të shoqërisë Civile

Individë që kanë një ide biznesi ose një projekt të lidhur me:

- artizanatin tradicional,
- prodhimin lokal me vlerë kulturore,

- turizmin kulturor apo ekoturizmin,
- produktet bio dhe bujqësinë e qëndrueshme ne zonat rurale
- teknologji të gjelbra apo menaxhim të mbetjeve.
- zhvillojne projekte edukative ose sensibilizuese per mjedisin

4.2.Biznese të vogla dhe të mesme ekzistuese (SME)

Subjekte të regjistruara ligjërisht që operojnë në sektorë si:

- zejjet dhe artizanati,
- turizmi rural, natyror dhe kulturor,
- prodhimet vendore me identitet gjeografik,
- menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore.
- guida të diversifikuara

5. Buxheti

Vlera totale e grantit për thirrjen është 4 000 000, e parashikuar në buxhetin 2025 dhe do të zbatohet për periudhën 2025-2026.

Granti për aplikim: Aplikimet që plotësojnë kriteret e kësaj skeme janë ato që kërkojnë një buxhet deri në 1 000 000 lekë për projekt propozim.

Fondet do t'u ndahen atyre aplikuesve, aplikimet e të cilëve janë në përputhje me Udhëzuesin e Aplikimit.

Bashkia Durrës rezervon të drejtën të mos i alokojë të gjitha fondet që ka në dispozicion në rast se projekt-propozimet e paraqitura nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara.



UDHËZUESI I APLIKIMIT

“Krijimi i një skeme garancie për bizneset në sektorin e mjedisit dhe të trashëgimisë kulturore, për të rinjtë, nëpërmjet mbështetjes financiare me grante”

Ky udhëzues përfshin të gjitha procedurat dhe dokumentacionin e detajuar të nevojshëm për të zbatuar në mënyrë profesionale dhe transparente skemën e grantit. Udhëzuesi bazohet në nenin 28 pika 6, të ligjit nr 139/2015 “Për vetë qeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligji nr. 9374, datë 21.04.2005 “Për ndihmën shtetërore” i ndryshuar, VKM nr. 817, datë 28.12.2005 “Për miratimin e rregullores për procedurat dhe formën e njoftimit”, Vendimin e Këshillit Bashkiak Durrës nr.115 datë 24.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afat mesëm 2025-2027 të Bashkisë Durrës” dhe Vendimit të Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr.126 datë 12.06.2025.

1. Çfarë është Granti për “Bizneset në sektorin e mjedisit dhe të trashëgimisë kulturore”

Granti për bizneset e vogla apo të mesme në sektorin e mjedisit dhe të trashëgimisë kulturore është një aktivitet i Bashkisë Durrës i financuar nga burimet publike, të parashikuara në zërin e buxhetit të Bashkisë Durrës 2025 në programin 04130 “Mbështetje për zhvillim ekonomik” i projektuar për të mbështetur financiarisht bizneset dhe iniciativat në fushën e mjedisit dhe të trashëgimisë kulturore, përfshirë këtu aktivitetet e artizanatit tradicional, prodhimet lokale me identitet gjeografik, turizmin kulturor dhe ekologjik si dhe teknologjitë inovative për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve, duke synuar orientimin e ekonomisë lokale drejt një modeli të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.

Kjo skemë granti është hartur për t’i shërbyer individëve sipërmarrës aspirantë, por edhe bizneseve të vogla dhe të mesme ekzistuese.

Projekti synon të mbështesë financiarisht këto kategori individësh, grupesh dhe njësisish ekonomike, të cilat kontribuojnë në sektorin e mjedisit dhe të trashëgimisë kulturore:

➤ Sipërmarrës të rinj

Individë ose grupe të reja që duan të krijojnë një biznes të ri në fushat e:

- turizmit të qëndrueshëm,
- artizanatit tradicional,
- bujqësisë ekologjike,
- menaxhimit të mbetjeve dhe ekonomisë qarkulluese,
- teknologjive të gjelbra.



- **Biznese ekzistuese të vogla dhe të mesme (SME)**
Subjekte të regjistruara që kërkojnë të:
 - zgjerojnë aktivitetin e tyre,
 - rrisin cilësinë e produkteve/shërbimeve,
 - investojnë në teknologji të pastër ose qëndrueshmëri,
 - kalojnë në forma më të formalizuara të operimit.
- **Artizanë dhe prodhues lokalë**
Individë ose grupe që ruajnë dhe zhvillojnë zanatet tradicionale dhe prodhimet me identitet kulturor lokal.
- **Fermerë ose agrobiznese**
Me fokus në prodhimin e qëndrueshëm, produktet bio, përdorimin e metodave tradicionale apo agroturizmin.
- **Organizata të shoqërisë civile (OSHC)**
Me projekt-propozime që lidhen me:
 - edukimin mjedisor,
 - përfshirjen e komunitetit,
 - ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore jomateriale,
 - aktivitete kulturore e artistike me impakt lokal.
- **Të rinj në zonat rurale**
Persona që synojnë të krijojnë një nismë ekonomike ose sociale në komunitetin e tyre.

2. Mbështetja financiare

Fondi total i Skemës së granteve 4.000.000 lekë dhe financohet plotësisht nga Bashkia Durrës.

Granti për aplikim: Aplikimet që plotësojnë kriteret e kësaj skeme janë ato që kërkojnë një buxhet deri në 1 000 000 leke për projekt propozim.

Granti do të mbështesë të rinjtë e moshës 18-30 vjeç, banues në Bashkinë Durrës, të cilët kanë një ide për krijimin e një biznesi të ri apo që kanë biznes ekzistues të vogël apo të mesëm dhe kërkojnë të kontribuojnë në sektorin e mjedisit dhe të trashëgimisë kulturore, për një projekt propozim me afat 6-12 muaj dhe shuma do të shpërndahet në bazë të planit financiar të aplikimeve fituese.

- Skema e grantit mbulon 100% të shpenzimeve të pranueshme brenda limitit të sipërpërmendur



- Grantet e alokuara në këtë thirrje mund të mbulojnë shpenzimet e personelit deri në masën 20% të shumës së kërkuar, pjesa tjetër prej 70% e fondit duhet të parashikohet për aktivitetet e projektit dhe 10% e fondit duhet të përdoret për dukshmëri dhe promovim.
- Granti nuk jepet më shumë se një herë për të njëjtën sipërmarrje, brenda 2 viteve.
- Efektet financiare për zbatimin e këtij aktiviteti do të përballohen nga buxheti i miratuar i Bashkisë Durrës.
- Bashkia ka të drejtë për të mos i ndarë të gjitha fondet në dispozicion nëse projekt-propozimet nuk i përmbushin kriteret e kërkuara.
- Aplikantët e përzgjedhur mund të planifikojnë financim tjetër shtesë (jo i detyruar) duke përdorur instrumente financiare (Kredi, Hua, Grante) të disponueshme në Shqipëri, nëpërmjet institucioneve financiare ose projekteve të financuara nga donatorë të tjerë ose financat e tyre. Në të gjitha rastet e mesiperme financimi shtesë duhet të deklarohet bashkë me burimin e financimit. Financimi shtesë duhet të përdoret së bashku me asistencën e grantit për fillimin e planit të biznesit, prandaj burimi i financimit duhet të përfshihet në planin e biznesit dhe do të jetë subjekt i vlerësimit.
- Nëse instrumenti financiar do të përdoret për zgjerimin e mëtejshëm të biznesit kjo mbështetje shtesë e përfituar pritet që të raportohet në vizitat dhe raportet e monitorimit .
- Shpenzimet e parakryera nuk do të njihen si investim por vetëm shpenzimet pas nënshkrimit të kontratës së grantit janë të vlefshme.
- Përfituesit e fondeve nuk janë të autorizuar për kalimin tek palë të treta . Të gjitha detajet specifike mbi kohën dhe pagesat do të përcaktohen në marrëveshjen kontraktuale të grantit në përputhje me projektin dhe specifikat e tij.

3. Likuidimi i shpenzimeve:

Pagesa e grantit të miratuar bëhet me transfertë bankare. Bashkia Durrës do të kryejë likuidimin e vlerës së kontratës sipas realizimit të planit të aktiviteteve përcaktuar në projekt, përgjatë të gjithë periudhës së vlefshmërisë së kësaj kontrate nga fondi i parashikuar në buxhetin e vitit 2025-2026 të Bashkisë Durrës.

Lëvrimi i shumës do të bëhet sipas planit të aktiviteteve . Kusht për lëvrimin e shumës është realizimi i shpenzimeve dhe dorëzimi i dokumentacionit mbështetës narrativ dhe financiar, dhe verifikimi i tij nga Drejtoritë përgjegjëse për shpenzimet që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me aktivitetet e biznesit sipas pikës 5.1 për periudhën kohore nga nënshkrimi kësaj kontrate deri në përfundim të saj.



4. Aplikantët e pranueshëm

Aplikantët e pranueshëm të skemës janë të gjithë individët shtetas shqiptarë në moshën 18-30 vjec, banorë të Bashkisë Durrës, të cilët kanë një ide për të krijuar një biznes ose zgjerimin e biznesit ekzistues në fushën e mjedisit dhe të trashëgimisë kulturore, i cili do të aplikohet në territorin e Bashkisë Durrës.

Aplikimet nga bizneset e reja dhe ekzistuese do të pranohen nëse plotësohen kriteret e sipërpermendura dhe nëse aplikuesi:

- Është i regjistruar dhe është banor në Durrës
- Është i ri/e re e moshës 18-30 vjec
- Nuk është në likuidim, falimentim apo procedurë mbyllje
- Ka paguar të gjitha detyrimet ndaj tatimeve si dhe taksat dhe tarifat vendore
- Është i gatshëm të regjistrojë biznesin e tij/ saj në Durrës brenda 15 ditëve para nënshkrimit të kontratës me Bashkinë Durrës .

5. Shpenzimet që mund të mbulohen nga skema :

5.1 Shpenzimet e pranueshme nga skema

Shpenzimet e njohura që mund të mbulohen nga paratë e grantit duhet të përdoren për zbatimin e planit të biznesit dhe mund të përfshijnë:

- Blerjen e makinerive, mjeteve dhe pajisjeve si dhe software dhe asete të tjera jo të prekshme të cilat do të shërbejnë për të diversifikuar prodhimin me produkte të reja në funksion të projekt propozimeve ose një ndryshim rrënjësor në procesin e përgjithshëm të prodhimit të këtyre produkteve.
- Shpenzime për asete të tjera të paprekshme licenca, markim patentim produktesh.
- Krijimin e një faqeje interneti ose publikimin ose reklamimi i aktiviteteve vetëm për 3 (tre) muajt e parë të fillimit dhe nuk mund të tejkalojë më shumë se 10% të grantit total (si për si për njësitë e reja ekonomike, ashtu dhe për ato ekzistuese)
- Pagat dhe shpenzimet do të mbulohen vetëm për të punësuarit që lidhen drejtpërdrejt me procesin e prodhimit të produkteve/shërbimeve deri në 3 muajt e parë nga fillimi i aktivitetit të biznesit por pa tejkaluar më shumë se 20% të shumës së grantit.

5.2 Shpenzimet që nuk mund të mbulohen nga skema

Shpenzimet që nuk mund të mbulohen nga granti përfshijnë :

- Shpenzimet e lindura, krijuara përpara nënshkrimit të kontratës së grantit
- Mirëmbajtje dhe riparime
- Vlera e qerasë së ambjentit para dhe mbas përfundimit të projektit

- Blerje e pasurive te patundshme
- Blerjen e mjeteve te transportit
- Cdo shpenzim që nuk lidhet me biznesin e propozuar
- Zbavitje dhe dhurata

6. Mbulimi gjeografik

Skema e dhënies së granteve do të zbatohet në territorin e Bashkisë Durrës .

7. Strukturat e skemës së grantit dhe detyrat e tyre

Skema e grantit do të zbatohet nga Bashkia Durrës, Drejtoria e Turizmit. Në këtë aktivitet do të përfshihen në disa hapa konkrete të zbatimit edhe struktura të tjera të Bashkisë Durrës, sipas fushës së thirrjes në cdo rast drejtoritë përgjegjëse do të përcaktohen në urdhërin e grupit të punës për organizimin dhe menaxhimin e shpalljes së thirrjes.

Skema do të zbatohet nga strukturat e mëposhtme:

- Komisioni i Vlerësimit
- Koordinatorët e skemës
- Ekspertët/mentorë për monitorimin
- Grupi i monitorimit për zbatimin, certifikimin, pranimin e shpenzimeve.

8. Strukturat e monitorimit të skemës

8.1 Komisioni i vlerësimit

Komisioni i vlerësimit të aplikimeve është organ i krijuar nga Bashkia Durrës i cili realizon vlerësimin e aplikimeve të dorëzuara në përputhje me kriteret e përcaktuara në skemën e grantit. Puna e komisionit do të jetë në përputhje me rregullat e skemës së grantit dhe kriteret e përcaktuara qartë për vlerësimin e aplikimeve. Ky komision do të ngrihet me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Durrës. Takimet e komisionit do të organizohen pranë ambienteve të Bashkisë Durrës. Anëtarët e Komisionit do të vlerësojnë secilin aplikim për ide biznesi në mënyrë të pavarur bazuar në kriteret e përcaktuara.



8.2 Koordinator i skemës së Grantit.

Përfaqësues nga Drejtoria e Turizmit do të shërbejë si koordinator të skemës dhe do të jenë përgjegjës të menaxhimit operacional të saj deri në momentin e lidhjes së kontratës me përfituesit. Koordinatorët janë përgjegjës për zbatimin në kohë të të gjitha aktiviteteve të skemës

dhe ndjekin kalendarin e miratuar deri në momentin e lidhjes së kontratës me përfituesit. Gjithashtu organizojnë takimet e komisionit të vlerësimit, sigurojnë shpërndarjen e dokumentacionit tek ata, si dhe mbledhin firmat nga të gjithë anëtarët e komisionit. Koordinatorët janë përgjegjës për menaxhimin e të gjitha dokumentave deri në momentin e lidhjes së kontratës me përfituesit dhe ruajtjen e tyre në arkiv. Koordinatorët e Skemës së grantit do të caktohet me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Durrës.

9. Mënyra e procedimit të skemës së grantit

Skema e grantit do të zbatohet në një cikël që ndjek hapat e mëposhtëm

- Shpallja e thirrjes në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Durrës dhe në media sociale
- Zhvillimi i fushatave informuese mbi kriteret e aplikimit
- Dorëzimi i aplikimeve
- Vlerësimi dhe përzgjedhja aplikimeve fituese
- Kontraktimi i aplikantëve fitues dhe përdorimi i fondeve
- Monitorimi dhe vlerësimi i projekteve fituese

9.1 Shpallja e thirrjes së grantit

Thirrjet për shprehjen e interesit do të shpallen në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Durrës dhe në media sociale. Thirrja do të qëndrojë e hapur jo më pak se 4 javë nga dita e shpalljes.

Një njoftim publik (Aneksi 1) do të hartohet nga koordinatorët e skemës. Njoftimi duhet të përfshijë informacionin për tërësinë e procesit të aplikimit dhe kriteret e pranueshmërisë. Ai duhet të përfshijë gjithashtu informacion për çdo takim informues që do të organizohet gjatë kohëzgjatjes së thirrjes. Njoftimi duhet të publikohet në faqen e internetit të Bashkisë Durrës dhe media sociale.

Shpallja e skemës së grantit do të publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës dhe do të përmbajë:

- Formularin e aplikimit për grantin
- Planin e biznesit dhe të financimit sipas modelit të kërkuar (certifikime, patenta të tjera dokumenta suportuese)

Dokumentat shtesë duhet të përmbajnë :

- Formularin e vetëdeklarimit
- Kopjen e kartës së identitetit
- Kopjen e ekstraktit të biznesit nga regjistri tregtar të lëshuar nga QKB për bizneset ekzistuese (nga e-albania)



- Të gjithë aplikantët që synojnë të hapin një biznes të ri kanë afat 15 ditë pas aprovimit të grantit dhe firmosjes së kontratës për regjistrimin e bizneseve të tyre pranë zyrave të QKB
- Vërtetimi origjinal për llogari bankare në lekë për bizneset ekzistuese. Bizneset e reja do të sjellin llogarinë bankare pasi pasi të jenë shpallur fitues dhe të jenë regjistruar në QKB.

Të gjithë aplikantët duhet ti qendrojnë në mënyrë rigoroze formatit të aplikimit dhe formave të bashkëngjitura në këtë udhëzim.

9.2. Fushata Informuese

Një fushatë informuese do të organizohet gjatë kohëzgjatjes së thirrjes me qëllim njohjen e aplikuesve të mundshëm me kriteret e kësaj skeme, mënyrën e aplikimit etj. Takimet informuese (Aneksi 2) duhet të organizohen në ambjentet e Bashkisë Durrës për të transmetuar informacionin e nevojshëm tek të gjithë aplikantët në mënyrë të standartizuar dhe të njejtë. Synimi i këtyre takimeve do të jetë shpërndarja e informacionit tek aplikantët e mundshëm të pranueshëm që në të kundërt do të kenë akses të kufizuar në kanalet formale të komunikimit.

Takimet informuese do të organizohen gjatë 2 javëve të para të fushatës, duke përdorur, një qasje hap pas hapi, aplikantët informohen për kushtet e përgjithshme të skemës, procedurat e aplikimit dhe kriteret e pranueshmërisë.

9.3. Dorëzimi i aplikimeve

Aplikimet e plotësuara me të gjithë dokumentacionin e detyrueshëm duhet të dorëzohen pranë sportelit të Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun, në Bashki në tre (3) kopje të printuara dhe një kopje elektronike (në CD ose USB) dorazi ose me postë zyrtare, në një zarf të vulosur mbi të cilin është shkruar emri i thirrjes publike me shënimin **"Formular aplikimi për pjesëmarrjen në skemën e granteve për biznese innovative për të rinjtë"**, emri i plotë dhe adresa e aplikantit.

Afati i dorëzimit të aplikimeve është(dita, data) deri në orën 16.00, gjatë ditëve të punës (e hënë deri të premten), midis orës 08.00 dhe 14.00, në adresën :

Bashkia Durrës
Adresa: Lagja nr.1, Sheshi "Liria",
2000, Durrës



Aplikimet e dërguara në mënyra të tjera (p.sh e-mail) ose që janë dërguar në adresë të tjera nuk do të merren parasysh.

Çdo aplikim i marrë pas datës përmbyllëse të shpallur do të konsiderohet i pavlefshëm.

Aplikimet pranohen sipas procedurave të mëposhtme:

- Një verifikim formal i adresës, kryhet në sportelin e Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun, dokumentet të cilat nuk kanë adresë, nuk do të pranohen.
- Çdo kandidati i caktohet një numër reference me datën dhe orën e dorëzimit.

9.4. Vlerësimi dhe përzgjedhja e aplikimeve

Shqyrtimi dhe vlerësimi i Aplikimeve do të kryhet nga Komisioni i Vlerësimit. Takimet e vlerësimeve do të organizohet nga Koordinatorët e skemës. Aplikimet do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga Komisioni i Vlerësimit, i cili do të përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët 3 janë përfaqësues të Bashkisë Durrës, një përfaqësues i Universitetit "Aleksandër Moisiu" dhe një përfaqësues nga organizata ndërkombëtare "World Vision".

Procesi për vlerësim administrativ dhe përzgjedhja e kandidatëve duhet të fillojnë jo më vonë se pesë ditë pune pas afatit përfundimtar për dorëzimin e aplikimeve. Të gjithë anëtarët e Komisionit duhet të jenë të panishëm në takim. Procesi nuk duhet të zgjasë më shumë se 3 (tre) ditë pune.

Përpara fillimit të procesit të vlerësimit, të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit duhet të nënshkruajnë me shkrim deklaratën e paanshmërisë dhe konfidencialitetit. Ky akt i detyron të ruajnë konfidencialitet të plotë të informacionit që përmbajnë aplikimet, si dhe paanshmëri në procesin e vlerësimit të aplikimeve. Nënshkrimi i deklaratës garanton integritetin e të gjithë informacionit. Brenda procesit të vlerësimit deri sa rezultatet të publikohen dhe të vihen në dispozicion të publikut të gjerë. Kjo mbron interesin e aplikantëve si dhe të gjithë pjesëtarëve të tjerë në këtë process.

Secili anëtar i Komisionit do të vlerësojë secilën ide biznesi individualisht si më poshtë:

Aplikimet do të vlerësohen në bazë të:

- (I) Kushteve administrative
 - Aplikimi është i kompletuar sipas kërkesave të thirrjes
 - Dokumentacioni është dorëzuar në 3 kopje të shtypura dhe në një kopje elektronike (CD apo USB).
- (II) Kushtet që kanë të bëjnë me Aplikuesin dhe aktivitetet:
 - Konfirmimi se aplikuesi dhe aktivitetet i përmbushin kushtet e specifikuar në Udhëzuesin për Aplikim.



(III) Vlerësimi i cilësisë së aplikimit dhe vlerësimi i planit të biznesit dhe të dhënave financiare.

Vlerësimi i aplikimeve do të bëhet në përputhje me kriteret e specifikuar në Tabelën Vlerësuese që është pjesë përbërëse e këtij dokumenti. Ka tre lloje të kriterëve vlerësues: kriteret e idesë së biznesit, kriteret e planit të biznesit dhe kriteret e dokumentacionit shtesë për trajnimet.

Ju lutem kushtoni vëmendje informacionit në vijim.

Kriteret e pikëzimit ndahen në seksione dhe nënseksione. Çdo nën-seksion duhet vlerësuar me pikët e përcaktuara nga 1 në 5 sipas mënyrës së mëposhtme: 1= shumë keq; 2= I keq; 3= I përshtatshëm; 4= I mirë; 5= shumë mirë. Çdo anëtar i komisionit plotëson një tabelë individuale vlerësimi dhe të gjithë anëtarët nënshkruajnë tabelën përmbledhëse të vlerësimit të aplikimeve. Renditja e aplikimeve bëhet duke u nisur nga aplikimi me numrin më të madh të pikëve, i ndjekur nga aplikimi pasardhës me më pak pikë.

Shënim për Seksionin 1. Zhvillimi i idesë së Biznesit

Projekti përjashtohet nga procesi i mëtejshëm i vlerësimit në rast se numri total i pikëve në Seksionin 1 është më i ulët se 25 pikë, sepse aplikimi i dorëzuar nuk garanton cilësinë e aplikimit.

Shënim për Seksionin 2. Kriteret e Planit të Biznesit dhe Financimit

Projekti përjashtohet nga shqyrtimi i mëtejshëm në rast se numri total i pikëve në Seksionin 2 është më i ulët se 35 pikë, sepse pikët tregojnë se megjithëse aplikanti garanton cilësinë e aplikimit, aplikimi nuk ofron një analizë të mirëfilltë financiare dhe plani i biznesit nuk është relevant.

Hapi I parë: Vlerësimi administrativ

Koordinatorët e Skemës asistojnë në shpërndarjen e të gjithë zarfave të marrë me aplikime, nëpërmjet nënshkrimit të një procesverbali të marrjes në dorëzim. Përpara se të bëhet shqyrtimi i hollësishëm i aplikimeve të dorëzuara, Komisioni kontrollon nëse aplikimet janë dorëzuar brenda kohëzgjatjes së thirrjes.

Më pas, anëtarët e Komisionit dhe Koordinatori hapin të gjithë zarfat. **Në rastin e dublikimeve të aplikimeve (më shumë se një aplikim për person) do të shpallet përfitues vetëm një aplikim, ai që ka idenë më të mirë të biznesit.**

Në rast se aplikimi nuk i plotëson kriteret teknike apo është dorëzuar përtej afateve të thirrjes, ai përjashtohet nga vlerësimi i mëtejshëm dhe shpallet i skualifikuar.

Hapi I dytë: Vlerësimi teknik dhe përzgjedhja e fituesve

Pas vlerësimit administrativ do të shqyrtohet përmbajtja e projektit, planit të biznesit sipas kritereve të përcaktuara. Anëtarët e Komisionit duhet të bien dakord me rezultatet përfundimtare dhe listën e pranuar të paneve të biznesit për financim.

Një nga Koordinatorët e skemës vepron si sekretar gjatë takimeve dhe harton procesverbalin e takimeve.

Së fundi, Komisioni rendit vlerësimin e aplikimeve sipas pikëve përfundimtare. *Të gjithë aplikimet të cilat kanë marrë vlerësime prej 70 pikësh ose më shumë do të pranohen për financim deri në përfundimin e të gjitha financimeve të akorduara për këtë skemë granti.*

Pas finalizimit të procesit të vlerësimit, Koordinatorët e Skemës do të përgatisin listën përfundimtare të aplikantëve dhe do ta dorëzojnë atë së bashku me Procesverbalin e Takimit (Ankesi 6), brenda tre ditësh pune.

9.5.Shpallja e rezultateve

Me përfundimin e procesit, rezultatet përfundimtare të vlerësimit nxirren në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Durrës. Për këtë qëllim, bashkia do të përgatitë një pasqyrë në formë tabele të të gjithë aplikantëve dhe pikëve totale të marra nga secili, pa dhënë pikët individuale që ka dhënë secili anëtar i Komisionit. Gjithashtu do të njoftohet Kryetari i Bashkisë Durrës me listën përfundimtare të fituesve.

Secili aplikant do të marrë një Njoftim me shkrim (Aneksi 9), të përgatitur nga Koordinatorë e Skemës dhe të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Durrës, sipas komenteve të Komisionit të Vlerësimit.



9.6.Ankesat

Pas botimit zyrtar të rezultateve, aplikuesit kanë të drejtë të ankimojnë rezultatin brenda *pesë ditësh pune* nga marrja e njoftimit. Të gjitha ankimimet e paraqitura brenda afatit përfundimtar shqyrtohen nga Komisioni i Vlerësimit, që duhet të informojë aplikantin për vendimin dhe përfundimet e tyre me shkrim brenda pesë ditësh pune.

Koordinatori i skemës në rolin e sekretarit do të kontaktojë me email ose telefon të gjithë aplikantët për ti njoftuar më rezultatet e vlerësimit.

Nëse gjatë procesit të vlerësimit konstatohet se dokumentet e aplikantit janë të rreme, këta aplikantë do të përjashtohen menjëherë.

Pikët përfundimtare për secilën ide biznesit llogariten nga mesatarja e pikëve të anëtarëve të Komisionit.

Së fundi, Komisioni rendit aplikantët sipas pikëve përfundimtare të secilës ide biznesi në rendin zbritës (nga aplikanti me pikët më të larta te ai me pikët më të ulëta). (Aplikantët me 70 pikë e lart do të përzgjidhen).

10. Kontraktimi i aplikimeve fituese dhe Përdorimi i Fondeve

10.1. Kontrata e Grantit

Procesi për regjistrimin e enteve ligjore (vetëm për individët) dhe firmosja e kontratës së grantit do të koordinohet nga Drejtoritë e tjera përgjegjëse brenda institucionit të Bashkisë. Pas regjistrimit, të gjithë aplikantët e miratuar duhet të hapin një llogari bankare në emër të biznesit të tyre (llogari biznesi).

Pas regjistrimit të subjektit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe hapjes së një llogarie bankare, kandidatët nënshkruajnë kontratën e grantit. Kontrata e standardizuar e grantit firmoset ndërmjet Bashkisë Durrës dhe përfituesit për një periudhë kohore prej **6 deri 12 muaj** që nga data e nënshkrimit. Plani i Biznesit dhe të gjitha bashkelidhjet e miratuara nga Komisioni Vlerësues do të përbëjnë një pjesë integrale të Kontratës së dhënies së grantit (Ankesi 10).

Gjatë zbatimit të kontratës, bizneset fituese mund të dorëzojnë kërkesën për amendimin e kontratës si dhe justifikimet e nevojshme të Koordinatorit, i cili do të informojë më pas Kryetarin e Bashkisë për propozimet e paraqitura. Kryetari do të vendosë për miratimin ose refuzimin e propozimit pasi të jetë konsultuar me Drejtorinë e Turizmit. Ndryshimet mund të bëhen vetëm gjatë periudhës së zbatimit të kontratës dhe nuk do të kenë fuqi prapavepruese. Ndryshimet e miratuara do të integrohen në një aneks të firmosur nga palët i cili do të përbëjë një pjesë integrale të kontratës.

Bashkia e Durrësit do të kryejë likudimin e vlerës së kontratës, sipas realizimit të planit të aktiviteteve të përcaktuar në aplikim, përgjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së kësaj kontrate.

Aplikanti i miratuar duhet ta përdorë grantin **brenda periudhës 6 deri në 12 muajve** nga data e nënshkrimit të kontratës së grantit.

Pas lidhjes së Kontratës së grantit ndërmjet Bashkisë Durrës dhe përfituesit të grantit do të ngrihet dhe Grupi i Monitorimit për zbatimin e këtij Granti.

Ky grup do të ngrihet me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Durrës.

11. Monitorimi dhe Vlerësimi

Për të ndjekur ecurinë e zbatimit të projektit fitues dhe për efekt monitorimi, është e nevojshme të krijohet një dosje për secilin projekt, ku përmban të dhënat administrative dhe financiare. Në këtë dosje duhet të arkivohen të gjitha **faturat origjinale** dhe dokumentet e tjera që lidhen me aplikimin.

Qëllimi i monitorimit të skemës, është monitorimi i zbatimit në kohë të kontratave duke filluar nga data e lidhjes së kontratës deri në përfundimin të tij, sipas kalendarit të miratuar nga Bashkia.

Ato do të monitorojnë suksesin dhe efektet e zbatimit të skemës duke monitoruar projektet e aplikantëve të shpallur fitues në këtë skemë grantesh. Çdo subjekt do të monitorohet çdo muaj nërmjet vizitave në terren çdo muaj. Vizitat në terren duhet të organizohen duke njoftuar paraprakisht përfituesit, brenda një afati nga një deri në tre ditë përpara vizitës së planifikuar. I gjithë informacioni i mbledhur gjatë vizitave në terren do të reflektohet në një Formular Monitorimi (Aneksi 12). Punonjësit do të diskutojnë dhe marrin vendim për të gjitha vëzhgimet dhe çështjet e identifikuara gjatë vizitave në terren.

Gjatë vizitave në terren, do të kontrollohen elementët e mëposhtëm të përmbushjes së qëllimeve të Skemës, të cilat do të parashtrihen me detaje në Formularin e Monitorimit:

- Ecuria e aktiviteteve në krahasim me planin e biznesit,
- Ndjekja e Kalendarit të Përdorimit të Grantit dhe Kontributit të Aplikantit;
- Organizimi i biznesit;
- Verifikimi dhe dobia e shpenzimeve;
- Ndikimi i përdorimit të grantit etj

Një raport përfundimtar për projektin do të hartohet nga grupi i punës për monitorimin e kontratave në fund të zbatimit, duke përfshirë një analizë dhe rekomandime për ndryshimet.

Tregues të Performancës së Skemës së Granteve

Treguesit e mëposhtëm statistikorë do të monitorohen gjithashtu gjatë zbatimit të skemës:

- Numri i dorëzuar i aplikimeve;
- Numri i kontratave të firmosura të grantit;
- Sektorët ekonomikë në të cilat funksionojnë bizneset;
- Numri i vendeve të hapura të punës gjatë procesit të realizimit të idesë së biznesit;

Skema do të vlerësohet pasi mbyllet cikli i Skemës së Grantit sipas treguesve të mëposhtëm:

- Numri i aplikantëve gra/burra të shpallura fitues;
- Numri total i bizneseve të mbështetura;
- Numri vendeve të punës të hapura;
- Arsytet për hapjen e bizneseve të reja nga të rinjtë të shpallur fitues;

- Linjat e reja të biznesit të hapura brenda bizneseve ekzistuese;
- Investime të reja (aktivitete biznesi/linja biznesi shtesë, biznese të reja etj);

Dokumentacioni i dërguar për likuidim

Vetëm pas realizimit të shpenzimeve, përfituesi i grantit do të dorëzojë kërkesën për likuidim shpenzimesh, e shoqëruar me dokumentacionin narrativ dhe financiar i cili vërteton përkatësinë e shpenzimeve sipas parashikimeve të planit të aktiviteteve. Përfituesi i grantit do të dorëzojë:

- Faturat dhe pagesat bankare (konfirmim pagese ose urdhër pagese) për secilën blerje
- Situacion nëse ka
- Kontrata ndërmjet biznesit dhe punonjësit nëse ka.
- Listëpagesa në formatin e deklaramentit tatimor ose Formulari E-SIG për stafin
- Dokumentet origjinale të firmosura nga banka për pagesën e pagës neto, kontributeve në llogari të punonjësit dhe komision bankar.

Bashkia Durrës nëpërmjet Drejtorive përgjegjëse do të kryejë monitorimin përkatës për çdo kontratë granti të nënshkruar dhe ka të drejtën të bëjnë inspektime në terren për të monitoruar, verifikuar apo për të kërkuar dokumentacionin shtesë për të vërtetuar të dhënat e raportuara nga përfituesi i grantit. I gjithë informacioni i mbledhur gjatë vizitave në terren do të reflektohet në një raportim ndërmjetës ose final.

Pas hartimit të raportit të ndërmjetëm dhe atij final të monitorimit dhe verifikimit të dokumentacionit të sjellë nga përfituesi i grantit, Drejtoria e Turizmit dërgon kërkesën për likuidim pranë Drejtorisë së Financës e cila përmban:

- Raporti narrative dhe financiar (bashkëlidhur dokumentacioni justifikues i shpenzimeve)
- Urdhër për ngritjen e grupit të monitorimit për projektet e shpallura fituese
- Raport i ekipit të monitorimit

Nëse aplikanti e përdor grantin për qëllime të tjera, por jo për biznesin e miratuar ose përfundon aktivitetin e biznesit pa një arsye objektive, Bashkia do të ndalojë menjëherë së financuari atë biznes dhe/ose do të fillojë një procedurë në gjykatën e rrethit Durrës për rikthimin e grantit.



Anekset

Aneksi 1 – Njoftimi Publik

Aneksi 2 – Njoftim për Takimet Informuese

Aneksi 3 – Formular Aplikimi për Ide Biznesi

Aneksi 4 – Formualar individual i vlerësimit

Aneksi 5 – Formulari Përmbledhës i Vlerësimit

Aneksi 6 – Procesverbali për Vlerësimin e Aplikimeve

Aneksi 7 – Format i Planit të Biznesit

Aneksi 8 – Procesverbal i mbylljes së Thirrjes së hapur pubike

Aneksi 9 – Njoftim për Aplikantët

Aneksi 10 – Kontrata për Dhënien e Grantit

Aneksi 11 – Raporti për Përdorimin e Grantit

Aneksi 12 – Formular Monitorimi

Aneksi 13 – Deklarata e paanshërisë dhe konfidencialitetit

Aneksi 14 – Formular për konfirmimin e marrjes në dorëzim të dokumentacionit

Aneksi 15 – Kërkesë për likuidim shpenzimesh

Aneksi 16 – Deklarata për plotësimin e kriterëve

Aneksi 17 – Listë Kontrolli e Dokumenteve





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës

Aneksi 1 – Njoftimi Publik

Njoftimi Publik

Thirrja e Bashkisë Durrës për mbështetje financiare nëpërmjet skemës së granteve për të rinj.

1.1.Hyrje

Në/...../..... (datë) Bashkia Durrës do të shpallë thirrjen: “Grante për të rinjtë në mbështetje të zhvillimit të iniciativave ekonomike lokale”, financuar nga burime publike, dhe do të shpallë konkursin e hapur për dorëzimin e aplikimeve për grante për të mbështetur krijimin, ose zgjerimin e aktivitetit të bizneseve ekzistuese nga të rinj të aftë për të qenë të qëndrueshëm në një treg konkures.

1.2.Qëllimi i Thirrjes

Qëllimi i kësaj thirrje është të mbështesë plane të qëndrueshme biznesi të krijuara nga të rinjtë e qytetit të Durrësit, të cilët shfaqin aftësi të mbijetojnë në një treg konkures. Procesi i përzgjedhjes së aplikantëve ka si qëllim të ofrojë transparencë dhe konkurrencë të barabartë si dhe të mbështesë idetë dhe planet e biznesit më të mira, inovative, fitimprurëse dhe që garantojnë rezultate të qëndrueshme.

Skema do të zbatohet në të gjithë territorin e Bashkisë Durrës

1.3.Mbështetja e Skemës

Skema e granteve synon të mbështesë të rinjtë në zhvillimin e ideve të biznesit të suksesshme dhe testimin e tyre për të tejkaluar vështirësitë e ndryshme të tregut.

Në rastin kur fitues janë individë, kusht për përfitimin e grantit do të jetë regjistrimi i biznesit të tyre në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB). Vetëm pas regjistrimit në QKB, bizneset mund të nënshkruajnë kontratën me Bashkinë Durrës.

1.4.Aplikantët e Pranueshëm

Granti do të mbështesë *të rinjtë e moshës 18- 30 vjeç, banues në Bashkinë Durrës, të cilët kanë një ide apo kanë një biznes ekzistues të vogël ose të mesëm* me një projekt propozim me afat nga **6 - 12 muaj** dhe shuma do shpërndahet në bazë të planit financiar të aplikimeve fituese.

Të gjitha aplikantët **duhet të kenë një ide për biznes**, që ka si qëllim fillimin ose zgjerimin e një biznesi të pavarur të vogël ose të mesëm.

Ato që nuk përmbushin kriteret për t'u përzgjedhur janë ato të cilat kanë konflikt interesi me palët e përfshira dhe vendimmarrësit e skemës së granteve. Për këtë aplikantët duhet të nënshkruajnë deklaratën e konfliktit të interesit.

Aplikantët mund të marrin pjesë në thirrje vetëm me 1 (një) ide biznesi.

1.5. Aktivitete Biznesi të Pranueshme

Aktivitetet e pranueshme për ide biznesi janë:

- artizanati tradicional,
- krijimi i një produkti lokal me vlerë kulturore,
- turizëm kulturor apo ekoturizëm,
- bujqësi e qëndrueshme në zonat rurale
- teknologji të gjelbra apo menaxhim të mbetjeve.
- projekte edukative ose sensibilizuese në mbrojtje të mjedisit

Nëse kandidatët do të jenë në kushte të barabarta, prioritet do t'i jepet aplikantëve:

- Të cilë paraqesin ide të veçantë për biznes (jo e përsëritur nga aplikantët e tjerë), ose të cilët ofrojnë produkte ose shërbime të reja;
- Të cilët paraqesin ide inovatore;
- Me biznese që krijojnë të paktën dy vende pune

1.6. Mbështetje financiare

Efektet financiare të këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i miratuar për Bashkinë Durrës për thirrjen: "Grante për të rinjtë në mbështetje të zhvillimit të iniciativave ekonomike lokale".

Aplikimet që plotësojnë kriteret e kësaj skeme janë ato që kërkojnë një buxhet deri në **1 000 000 lekë për projekt propozim**. Ky instrument financiar do të përdoret edhe në rastet e zgjerimit të mëtejshëm të bizneseve ekzistuese të shpallura fituese.

1.7. Shpenzimet e pranueshme nga skema

Shpenzimet e pranueshme që mund të mbulohen nga fondi i grantit duhet të përdoren për zbatimin e planit të biznesit të paraqitur dhe mund të përfshijnë:

- Blerjen e makinerive, mjeteve dhe pajisjeve, si edhe software dhe asete të tjera jo të prekshme (nëse ka të tilla) të cilat do të shërbejnë për të diversifikuar prodhimin me produkte të reja ose një ndryshim rrënjësor në procesin e përgjithshëm të prodhimit të këtyre produkteve;
- Marrje me qira për ambiente (nëse ka);

- Shpenzime për asete të tjera të paprekshme (licenca, markim dhe patentim produktesh);
- Krijimi i një faqeje interneti, publikim ose reklamim i aktiviteteve vetëm për 3 (tre) muajt e parë të fillimit dhe nuk mund të tejkalojë më shumë se 10% të grantit total (si për njësitë e reja ekonomike edhe për ato ekzistuese);
- Pagat dhe sigurimet do të mbulohen vetëm për të punësuarit që lidhen drejpërdrejt me procesin e prodhimit të produkteve/shërbimeve, deri në 3 muajt e parë nga fillimi i aktivitetit të biznesit por pa tejkaluar më shumë se 20% të grantit.

1.7.1. Shpenzimet e panjohura nga skema

Shpenzimet që nuk mund të mbulohen nga fondi i grantit përfshijnë:

- Shpenzimet e lindura/krijuara përpara nënshkrimit të kontratës së grantit;
- Mirëmbajtje dhe riparime
- Blerjen e pasurive të patundshme (tokë, godina etj)
- Blerjen e mjeteve të transportit
- Çdo shpenzim që nuk lidhet me biznesin e propozuar
- Zbavitje dhe dhurata

Shpenzimet jo të pranueshme në grant mund të mbulohen nëpërmjet kontributit personal të aplikantit dhe formave të tjera të financimit, të cilat nuk janë pjesë e fondeve që vendos Bashkia Durrës.

Në rastin e fituesit, kalimi i fondit në palë të treta është i ndaluar.



1.8. Si të aplikoni

Aplikimet e plotësuara me të gjithë dokumentacionin e detyrueshëm duhet të dorëzohen pranë zyrës së Marrëdhënieve me Publikun, në Bashkinë Durrës. Aplikimet duhet të dorëzohen në tre (3) kopje të printuara dhe një kopje elektronike (CD ose USB) dorazi dhe me postë zyrtare, në një zarf të vulosur mbi të cilin është shkruar emri i thirrjes publike ***“Formular aplikimi për pjesëmarrjen në skemën e granteve për biznese për të rinjtë”***, emri i plotë dhe adresa e aplikantit.

Aplikimet e dërguara në mënyra të tjera (p.sh. email etj) ose që janë dërguar në adresa të tjera, nuk do të merren në shqyrtim.

Afati i fundit për dorëzim nuk është më vonë se/..../2025, ora __: __.

Çdo aplikim që merret pas datës së shpallur të mbylljes do të quhet i pavlefshëm.

Çdo aplikant mund të aplikojë me vetëm një ide biznesi.

1.9.Dokumentacioni i cili duhet dorëzuar për aplikimin:

Propozimet që do të dorëzohen duhet të përfshijnë dokumentat e mëposhtme:

1. Formulari i Aplikimit;
2. Plani i Biznesit dhe Financimit sipas modelit të kërkuar (çertifikime/patenta, apo dokumente të tjerë suportues të cilët vërtetojnë elementin eko inovativ për bizneset ekzistuese dhe start up përbëjnë bonus);
3. Kopja e kartës së identitetit të Aplikantit;
4. Kopja e ekstraktit të biznesit nga QKB për bizneset ekzistuese (nga e-albania);
5. Të gjithë aplikantët që synojnë të hapin një biznes të ri, kanë afat 15 ditë pas aprovimit të Grantit nga Komisioni i Vlerësimit për regjistrimin e biznesit të tyre pranë zyrave të QKB;
6. Vërtetim nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave vendore nëse aplikanti nuk ka detyrime financiare ndaj këtij institucioni (për aplikantët të cilët kanë biznes ekzistues);
7. Vërtetim origjinal për llogari bankare në lekë për bizneset ekzistuese (Bizneset e reja do të sjellin llogarinë bankare pasi të jenë shpallur fitues dhe të jenë regjistruar në QKB);
8. Vërtetim për saktësim adrese.

Të gjithë aplikantët duhet t'i qëndrojnë në mënyrë rigoroze formatit të aplikimit dhe formateve të bashkëlidhura këtij udhëzimi.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës

Aneksi 2 – Njoftim i Takimeve Informuese

Njoftim i Takimeve Informuese

Në datën .../.../..., ora jeni i ftuar të ndiqni një takim informues për thirrjen e Bashkisë Durrës, “Grante për të rinjtë në mbështetje të zhvillimit të iniciativave ekonomike lokale”, i cili do të ofrojë asistencë financiare në mbështetje të planeve të biznesit të aplikimeve fituese për zbatimin e ideve për vitin 2025-2026.

Mendoni se keni një ide biznesi të suksesshme dhe nuk keni mbështetje financiare? Mos hezitoni! Thirrja e Bashkisë Durrës për të rinjtë ofron një mundësi për të financuar idenë tuaj të biznesit në përputhje me Udhëzimin e Aplikimit.

Kandidatët dhe pjesëmarrësit në skemë janë ***të rinj të moshës 18-30 vjeç, banues në Bashkinë Durrës të cilët kanë një ide për krijimin e një biznesi të ri apo që kanë një biznes ekzistues të vogël ose të mesëm dhe kërkojnë të shndërrohen në biznese në fushën e Mjedisit dhe të Trashëgimisë Kulturore***, në kohën e aplikimit.

Fondi për “Grante për të rinjtë në mbështetje të zhvillimit të iniciativave ekonomike lokale” është projekt i Bashkisë Durrës i financuar nga burime publike dhe hartuar për të mbështetur krijimin, e bizneseve të reja ose zgjerimin e aktiviteteve të mundshme për biznes nga të rinj që janë të aftë që të jenë të suksesshëm në një treg konkurrues.

Skema është zbatuar përmes një procesi konkurimi, për të marrë kështu fitimin më të lartë të mundshëm nga investimi. Procesi i përzgjedhjes së aplikantëve ka si qëllim të sigurojë transparencë dhe konkurrencë të drejtë dhe të mbështesë idetë dhe planet e biznesit më të mira, inovative dhe me shumë përfitim si dhe garantojnë rezultate të qëndrueshme.

Takimi do të ndiqet nga Koordinatorët dhe gjatë takimit do të prezantohen kushtet për pjesëmarrje, afatet për aplikim dhe fazat e zbatimit të skemës së grantit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës

Aneks 3 – Formulari i Aplikimit

• **Informacione kontakti**

Emri dhe Mbiemri i Aplikantit:	
Adresa:	
Numri i telefonit:	
E-mail:	
Numri i Kartës së Identitetit:	
Niveli i arsimit, fusha e arsimit *	
Aftësi të tjera *	
Profesioni *	



*Opsionale

• **Biznesi im është** (klikoni njërin prej kutive):

☐ Individ (i paregjistruar)

☐ Biznes ekzistues (i regjistruar)

• **NIPT-i i biznesit**, (nëse e aplikueshme):

.....

- **Sektori i biznesit**, (klikoni njërën prej kutive):

☐ Mjedis

☐ Trashëgimi Kulturor

☐ Turizëm

- **Titulli i projektit**, (Shkruani një titull të shkurtër për aplikimin):

.....

- **Kohëzgjatja e projektit**, tregoni numrin e muajve që nevojiten për realizimin (maksimumi deri në 6 - 12 muaj). Sa kohë keni që punoni me idenë/biznesin dhe sa keni avancuar në implementimin e projekt-idesë tuaj?



.....

- **Shuma e financimit që kërkon nga granti** (e shprehur në lekë):

.....

- **Jepni një përshkrim të shkurtër të idesë tuaj të biznesit:**

.....

- **Biznesi im do të ofrojë produktet/shërbimet e mëposhtme:**

.....

- **Do të shes produktet/shërbimet e mia në** (përshkruani tregun tuaj):

.....

- **Konkurrenca ekzistuese dhe avantazhi konkurrues i biznesit tim:**

.....

- Aftësitë, përvojat dhe njohuritë që zotëroj për të zhvilluar këtë biznes:

.....

- Zgjedhja e kësaj ide biznesi sepse:

.....

**Ju lutemi bashkangjisni edhe dokumente shtesë që vërtetojnë arsimin, aftësitë dhe eksperiencat e sipërpërmendura.*

Dokumentacioni i aplikimit për thirrjen publike do të jetë i disponueshëm nga data (data, ora) në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës. **Data e mbylljes së dorëzimit të dokumenteve të aplikimit është data ora ...:....** Lista e aplikantëve të aprovuar do të publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës: www.durres.gov.al më(data)



Unë i/e nënshkruara me nr. IDbanuese ne Durrës, adresa;deklaroj se të dhënat që përmban ky aplikim janë dhënë me vullnetin time të lirë, në përputhje me mbrojtjen e të dhënave personale, të garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe në përputhje me Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i cili garanton konfidencialitetin e të dhënave të klientit dhe në këtë mënyrë jap shprehimisht pëlqimin tim që ato të përdoren nga Bashkia e Durrësit për qëllime të kryerjes së aktivitete të saj.

Nënshkroi:

Data



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës

Aneksi 4 – Formulari individual i vlerësimit

FORMULARI INDIVIDUAL I VLERËSIMIT

Aplikanti: _____

☐ Individ (i paregjistruar)

☐ Biznes ekzistues (i regjistruar)



Kriteret	Vlerësimi	Vlerësimi
Zhvillimi i idesë së Biznesit	35	
A është aplikimi i formuluar qartë dhe në përputhje me qellimin e thirrjes?	5	
A përputhet aplikimi me kriteret e thirrjes së bërë?	5	
A janë rezultatet e pritshme afatgjata dhe a ndikojnë në ekonominë lokale?	5	
A përfshin aplikimi produkte/shërbime?	5	
A përfshin aplikimi qasje inovative dhe modele të praktikës së mirë për bizneset e tjera?	5	
A kanë aktivitetet e propozuara ndikim konkret në mjedis?	5	
A bën projekti avokim për barazinë gjinore dhe nxitjen e të rinjve në punësim dhe sipërmarrje?	5	
Kriteret e Planit të Biznesit dhe Financimit	45	
A është buxheti i saktë ndërmjet kostove të personelit, aktiviteteve dhe vizibilitetit?	5	
A janë të pasqyruara qartë nevojat e konsumatorit për shërbime/produkte ?	5	

A është analiza e tregut e detajuar dhe e saktë?	5	
A është identifikuar dhe analizuar në mënyrë të plotë konkurrenca ?	5	
A janë të ardhurat reale (totali i të ardhurave, të ardhurat sezonale, rritja e shitjeve) dhe fitimi neto real ?	5	
A është specifikuar qartë cili është ekipi i ndërmarrjes/sa punonjës kanë?	5	
A është identifikuar qartë cili është modeli i të ardhurave, tregu i synuar dhe kush janë klientët?	5	
A janë shpenzimet e sugjeruara të nevojshme dhe të justifikuara për zbatimin e projektit?	5	
A krijon aplikimi hapjen e të paktën dy vendeve të reja të punës?	5	
Dokumentacioni dhe njohja e tregut	20	
A ka aplikanti kapacitete të mjaftueshme profesionale? (njohuri specifike në fushën përkatëse) ?	5	
A ka ofruar aplikanti dokumentacionin që ka lidhje me licensen, marken, patentën e produkteve të biznesit?	5	
A është aplikanti i familjarizuar me rregulloret përkatëse për këtë lloji biznesi?	5	
A ka aplikanti ambiente të gatshëm për zhvillimin e idesë së biznesit?	5	
TOTALI	100	





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës

Aneksi 5 – Formulari përmbledhës i vlerësimit

Aplikanti: _____

Kriteret	Vlerësimi	Vlerësimi
Zhvillimi i idesë së Biznesit	35	
A është aplikimi i formuluar qartë dhe në përputhje me qëllimin e thirrjes?	5	
A përputhet aplikimi me kriteret e thirrjes së bërë?	5	
A janë rezultatet e pritshme afatgjata dhe a ndikojnë në ekonominë lokale?	5	
A përfshin aplikimi produkte/shërbime?	5	
A përfshin aplikimi qasje inovative dhe modele të praktikës së mirë për bizneset e tjera?	5	
A kanë aktivitetet e propozuara ndikim konkret në mjedis?	5	
A bën projekti avokim për barazinë gjinore dhe nxitjen e të rinjve në punësim dhe sipërmarrje?	5	
Kriteret e Planit të Biznesit dhe Financimit	45	
A është buxhetimi i saktë ndërmjet kostove të personelit, aktiviteteve dhe vizibilitetit?	5	
A janë të pasqyruara qartë nevojat e konsumatorit për shërbime/produkte ?	5	
A është analiza e tregut e detajuar dhe e saktë?	5	
A është identifikuar dhe analizuar në mënyrë të plotë konkurrenca?	5	
A janë të ardhurat reale (totali i të ardhurave, të ardhurat sezonale, rritja e shitjeve) dhe fitimi neto real?	5	

A është specifikuar qartë cili është ekipi i ndërmarrjes/sa punonjës kanë?	5	
A është identifikuar qartë cili është modeli i të ardhurave, tregu i synuar dhe kush janë klientët?	5	
A janë shpenzimet e sugjeruara të nevojshme dhe të justifikuara për zbatimin e projektit?	5	
A krijon aplikimi hapjen e të paktën dy vendeve të reja të punës?	5	
Dokumentacioni dhe njohja e tregut	20	
A ka aplikanti kapacitete të mjaftueshme profesionale? (njohuri specifike në fushën përkatëse) ?	5	
A ka ofruar aplikanti dokumentacionin që ka lidhje me lincencen, marken, patentën e produkteve të biznesit?	5	
A është aplikanti i familjarizuar me rregulloret përkatëse për këtë lloji biznesi?	5	
A ka aplikanti ambiente të gatshëm për zhvillimin e idesë së biznesit?	5	
TOTALI		





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës

Aneksi 6 – Procesverbali për Vlerësimin e Aplikimit

Procesverbali për Vlerësimin e Aplikimit

Më/.../.... (data) Komisioni i Vlerësimit u mbledh dhe shqyrtoi..... (numri) aplikime, të ardhura deri (ora) më (data).

Aplikimet e dorëzuara nga individ (të paregjistruar) janë (numri)

Aplikimet e dorëzuara nga bizneset ekzistuese (të regjistruar) janë (numri)

Gjatë shqyrtimit të aplikimeve, Individët, Aktivitetet e biznesit të mëposhtme rezultuan të papranueshme sipas kriterëve të vendosura në skemën “Grante për të rinjtë në mbështetje të zhvillimit të iniciativave ekonomike lokale” për bizneset në Bashkinë Durrës:



Nr.	Emri i Aplikantit	Arsyet e mospranimit

Në bazë të kriterëve dhe pikëve të mbledhura për vlerësimin, aplikimet e pranuar nga individët dhe bizneset ekzistuese u vlerësuan si më poshtë:

Nr.	Emri i Aplikantit	Pikët totale	Vlerësimi përfundimtar

Sipas rregullave të skemës së granteve të Bashkisë Durrës, nëse një prej aplikantëve të pranuar nuk paraqitet për firmosjen e kontratës, vendi i tij do të zihet nga aplikantët pasardhës në renditje.



Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit

1..... 2..... 3.....

4..... 5.....



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës



Aneksi 7 – Formular për Plan Biznesi

FORMULAR PËR PLAN BIZNESI

• TË DHËNAT PERSONALE TË APLIKANTIT

Emri, Mbiemri	
Emri i biznesit (nëse jeni në biznes)	
Adresa:	
Tel.:	
E-mail:	
Dita e fillimit të biznesit	
Forma ligjore	

Në formatin e mëposhtëm jepet një përshkrim i shkurtër me udhëzime për çdo paragraf për t'ju orientuar sa më drejt në kryerjen e analizave të nevojshme me qëllim që të përgatitni një plan sa më të përafërt me realitetin. Në përfundim të planit ju mund ti hiqni këto pjesë të formatit.

I. PËRMBLEDHJE E SHKURTËR E PLANIT TË BIZNESIT

Përmbledhja ekzekutive plotësohet në fund, pasi të jenë plotësuar të gjitha seksionet. Shkruajeni këtë seksion dhe përmbledhni të gjitha pikat kryesore në planin tuaj të biznesit në jo më shumë se dy faqe.

- Një paragraf që përshkruan idenë tuaj të biznesit (përcaktimi i misionit dhe qëllimi specifik i planit);
- Procesin e krijimit dhe prodhimit të produkteve;
- Strategjia e marketingut (imazhi i biznesit, cilët janë klientët dhe si do tërhiqen ata);
- Qasja;
- Personeli (kush është pronari dhe përgjegjës për menaxhimin);
- Një përmbledhje të shkurtër të parashikimeve financiare;
- Përmbledhje se si do të kryhet financimi.

II. PROFILI I SIPËRMARRËSIT /PROFILI I BIZNESIT



Emërtimi i biznesit:

Lloji i biznesit:

NIPT i biznesit:

Viti i regjistrimit të biznesit:

Adresa e biznesit (vendndodhja):

Emri i Sipërmarrësit:

Ditëlindja:

Numri i telefonit:

E-mail:

Adresa e sipërmarrësit:

Arsimi formal:

Arsimi/formimi profesional:

Kurse të tjera profesionale afatshkurtëra:

Tjetër (nëse mendon se nevojitet):

A ka nevojë për ndonjë licencë/leje të veçantë për të ushtruar biznesin tuaj?

Nëse PO, çfarë lloj licencash/leje?

A i keni siguruar tashmë licencat/lejet e nevojshme?

NËSE JENI SIPËRMARRËS I RI, që nuk jeni akoma në biznes, lutemi bëni një përshkrim të aftësive tuaja, që ju bëjnë të mendoni se jeni të aftë për të kryer këtë biznes (1 faqe):

- Analizoni sa të angazhuar jeni ju: Cilët janë stimujt personale, Këmbëngulja, Besimi në vetvete. Entuziazmi, Investimi i kohës/Përpjekjet
- Analizoni aftësitë tuaja: Arsimi dhe trajnimi, Përvoja në menaxhim, Aftësi që ndihmojnë në punë, Përvoja të mëparshme në sektorin e biznesit, Sa keni kontakte me bizneset në këtë fushë.
- Analizoni cilësitë tuaja personale: Përgjegjshmëria, Ambicia, Novatorizmi, shkathtësia, etj.

NËSE E KENI HAPUR BIZNESIN, lutem bëni një përshkrim të biznesit tuaj sipas pikave më poshtë (1 faqe):

- Qëllimi i shoqërisë dhe veprimtaria e saj;
- Vendndodhja e biznesit tuaj (vendndodhjen në krahasim me tregun);
- Sa personel keni;
- Disa të dhëna financiare të shoqërisë për 2 ose 3 vitet e fundit (prsh. xhiro, fitimi);
- Shkurtimisht të përmendni produktet që shisni tek klientët;
- Planet aktuale dhe fushën e zgjerimit në të ardhmen. Si p.sh. xhiro vjetore, kufijtë e fitimit, nese zgjeroni pikat e shitjes, ndërtesat, zyrat, produktet e reja në treg, etj.



III.PRODUKTET/SHËRBIMET

Lutemi bëni një përshkrim të produktit/eve dhe /ose shërbimit që do të ofroni në treg. Është e rëndësishme që të keni të qarta llojet e ndryshme të produkteve/shërbimeve që do të ofroni (ose që planifikoni të ofroni), pasi kjo është e lidhur me seksionet e tjera të planit, dmth me identifikimin e klientëve apo përcaktimin e segmentit të tregut ku do të shërbeni. Në rast se jeni në biznes, plani duhet të përfshijë edhe produktet e tjera që ju keni aktualisht. Listimi i produkteve duhet bërë i veçantë, pasi ato mund të lidhen me tipe të ndryshme klientësh dhe me nevoja të ndryshme.

Më poshtë janë renditur një sërë pyetjesh që ju ndihmojnë për të plotësuar këtë seksion. Një pjesë e përgjigjeve të këtyre pyetjeve nuk mund të merren me mend por kërkojnë kryejën e një STUDIMI TREGU, veçanërisht kur duam të bëjmë krahasimet me produktet konkurrense për të nxjerrë në pah dallimet e tyre me produktin tonë.

Jepni informacione sipas pyetjeve të mëposhtme, përfshirë çmimin dhe si është përcaktuar çmimi (jo më shumë se 2 faqe).

- Përshkruani llojin e produkteve apo shërbimeve me të cilat do të synoni të futeni në treg.
- Cilat janë arsyet për zgjedhjen e këtyre produkteve/shërbimeve?
- Cilat janë tiparet kryesore të produkteve/shërbimeve tuaja?
- A ka produkte/shërbime të tilla në treg dhe përshkruaj se çfarë i dallon produktet e tua nga ato që janë aktualisht në treg?
- Cilat janë disa prej vlerave të veçanta ose unike që kanë produktet/shërbimet e tua? (P.sh dizenjimi, shija)
- Cilat janë grupet kryesore (më të rëndësishme) të klientëve të synuar për të cilët ju dëshironi të krijoni vlerë me produktet apo shërbimet tuaja?

IV. ANALIZA E TREGUT

4.1 Nevojat e Tregut (1/2 faqe)

Jepni arsyet pse po hyni në treg me produktet tuaja.

- Pse i kërkon tregu këto produkte/shërbime?
- Cilat janë tendencat e sotme të njerëzve që kërkojnë produktet/shërbimet tuaja?

4.2. Madhësia dhe Lokalizimi i tregut (1/2 faqe)

Lokalizimi i tregut dhe madhësia e tij duhet të përcaktohen bazuar në të dhëna, statistika, informacione nga pikat e shitjes, nga përfaqësuesit e shitjeve, apo njerëz të tjerë që kanë njohuri mbi këtë treg, si edhe direkt prej konsumatorëve.

- Sa i madh është tregu juaj, psh. Ku është i vendosur nga ana gjeografike?
- Sa njerëz ose familje mund të blejnë produktin/shërbimin tuaj?

4.3 Klientët dhe pritjet e tyre (1/2 faqe)

Identifikoni cilat janë tiparet karakteristike të klientëve tuaj, pozicionin gjeografik (pra ku banojnë klientët tuaj), si dhe të dhëna demografike në lidhje me ta.

- Do të shisni tek bizneseve të tjera, psh. tek shitësve me shumicë apo me pakicë (përshkruani se cilët janë këto biznese, në cilin sektor, ku ndodhen, sa të mëdhenj janë, et.)
- Do të shisni direkt tek konsumatori, nëpërmjet pikës suaj të shitjes, ose rrjetit tuaj, online, etj. (Të cilës moshë janë klientët, a kanë të ardhura, çfarë preferojnë ata, çfarë arsime kanë?)
- A mendoni se blerjet e produkteve/shërbimeve tuaja do jenë në rritje apo po tkurren?

4.4 Analiza e konkurrencës (1/2 faqe)

Si do të hyni ju në treg? Me disa produkte? Në një zonë të caktuar dhe me klientë të përcaktuar?

A do t'ju konkurrojnë konkurrentët tuaj me një produkt të caktuar, me klientë të caktuar apo me zona të përcaktuara? Cilat produkte dhe biznese konkurrojnë me ju? Citoni avantazhet që ju diferencojnë nga konkurrentët tuaj.

- Listoni emrat dhe adresat e konkurrentëve tuaj kryesorë

Konkurrenti A	
Emri i biznesit	
Adresa	

Konkurrenti B	
Emri i biznesit	
Adresa	



- Shënoni në tabelë në cilat nga këto elementë jeni më të fortë ose më të dobët ju dhe konkurrentët tuaj.

Elementët e analizuar	Biznesi juaj		Konkurrenti A		Konkurrenti B	
	Pikat e Forta	Pikat e Dobëta	Pikat e Forta	Pikat e Dobëta	Pikat e Forta	Pikat e Dobëta
Produktet						
Çmimi						
Cilësia						
Shërbimi						
Paketimi						
Shpërndarja						
Pjesa e tregut						
Pozicionimi në treg						
Pikat e shitjes						

Metodat e shitjes						
Reklama						
Imazhi i biznesit						

V. PLANI I MARKETINGUT (jo më shumë se dy faqe)

Në këtë pjesë të planit duhet të jepni informacion mbi marketingun dhe veprimet në kuadër të planit të marketingut.

- Qëllimi i marketingut – Jepni një përshkrim se si do të jetë biznesi juaj në do të ardhmen dhe se si do ta përshtatni në treg.
- Objektivat e marketingut – vendosni një deri në katër objektiva specifike, që maten ose realizohen- psh sa do rritet xhiroja, fitimi, sa pika te reja shitjeje do hapni, etj.

5.1 Produkti

- Cili është tipari i veçantë/unik për shitjen e secilit prej produkteve tuaja, që do të konsiderohet nga ju edhe si avantazhi juaj konkurrues në raport me produktet e tjera konkurruese në treg? Jepni një përshkrim për qasjen eko-inovative.
- Jepni një informacion të plotë rreth karakteristikave të produkteve/shërbimeve (p.sh. zhvillimi i produkteve apo lloji i shërbimit, tiparet, materiali i përdorur, përmasat, paketimi, vlera e përdorimit, etj.);

5.2 Çmimi

Jepni informacion duke shpjeguar metodën e vendosjes së çmimeve të produkteve të reja. Për bizneset e vogla, mbajtja e çmimit të ulët nuk është një politikë e mirë.

- Sa do të jetë çmimi i shitjes?
- Si mendoni të shisni në fillim me çmim të lartë dhe pastaj ta ulni, apo të kundërtën, do ofroni oferta?
- A është i rëndësishëm çmimi që klientët të blejnë produkteve tuaja?

5.3 Shpërndarja e Produkteve/Shërbimeve

Duhet të jepet informacion se si do të shiten në treg produktet/shërbimet tuaja

- Si do të shiten produktet tuaja? Direkt nga ju apo me shpërndarës tjetër?
- Ku do të shiten produktet tuaja? (p.sh. A do të hapet një pikë për shitje? Do të shiten me porosi? Apo nëpërmjet shitësve me shumicë apo ndërmjetësve? Online?

5.4 Promocioni

Plani i promocionit duhet të mbajë parasysh çështjet që lidhen me imazhin e biznesit. Sepse krijimi i një imazhi pozitiv do të tërheqë klientët që synoni.

- A do krijoni imazhin e kompanisë tuaj nëpërmjet reklamës apo pozicionimit të pikës së shitjes, çmimit, paketimit, etj.
- Çfarë lloj reklame do të bëni? A keni gjetur koston më të lirë por me efekt më të madh?
- A do të përdorni ndonjë fletëpalosje apo material tjetër promocional për shitjen e produkteve tuaja?



5.5 Plani i buxhetit të marketingut

(Lutem vendosni në tabelë veprimtaritë që kanë lidhje me idenë tuaj të biznesit)

- Sa lekë do të shpenzoni për marketingun që keni përshkruar më lart?

VI. MENAXHIMI DHE ORGANIZIMI

Shpjegoni veprimtarinë e përditshme të biznesit, vendndodhjen, pajisjet, personeli, proceset, burime të tjera, etj.

6.1 Vendndodhja, personeli, furnitorët

- Përshkruani vendndodhjen e biznesit, hapësira, pozicionimi, kostoja (qeraja, dhe mirëmbajtja, orari i punës).
- Sa persona do të punësohen, a janë të kualifikuar, çfarë punësh do të kryejnë dhe a do t'i trajnoni?
- Cilët janë furnitorët kryesorë, çfarë lloj produkti do të blini tek ata, me çfarë çmimesh?

6.2 Makineri dhe pajisje, mobilje (nëse ka)

(Lutemi përshkruani të gjitha pajisjet që ju nevojiten për fillimin e punës. Për vlerësimin e çmimit duhet të merrni ofertat për secilën prej tyre. Lutemi plotësoni të dhënat e kërkuara në tabelën e mëposhtme)

- Lloji i makinerisë apo pajisjes, Karakteristikat teknike, Kapaciteti përpunues, Viti i prodhimit (e re ose e përdorur), Çmimi i blerjes ose i marrjes me qira.

6.3 Forma ligjore e biznesit dhe dokumentacioni

- Si është e regjistruar në QKB Biznesi juaj? Apo si do ta regjistroni? Person fizik, apo shpk?

6.4 Burimet e financimit

Bashkëfinancimi apo kontributi i vetë biznesit duhet të jetë minimumi në vlerën 20% të vlerës totale të propozimit dhe mund të jetë nga burime alternative ose financime të tjera nga institucione financiare, por mund të shprehet me kontribut në natyrë (in-kind), që mund të jenë paga, vlerë qeraje ambjenti (për bizneset ekzistuese), vlerë pajisjesh ekzistuese, etj.

Nr.	Përshkrimi i financimit	TOTALI NË LEKË
1	Financim nga Granti	
2	Kontributi i vetë Biznesit (nëse ka)	
3	Burime të tjera financiare (nëse ka)	
	TOTALI I BURIMEVE TË FINANCIMIT NË LEKË	

VII. PLANI I VEPRIMIT

Lutem bëni një plan të thjeshtë se si do t'i parashikoni veprimet në të ardhmen.

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	ORGANIZIMI	PERIUDHA	PËRGJEGJËSI
Regjistrimi i Biznesit në QKB			
Marrja e Licensës (nëse kërkohet)			
Blerja e pajisjeve (nëse ka)			

Blerja apo marrja me qira për ambientin (nëse ka)			
Blerje software (nëse ka)			
Rekrutimi i personelit			
Kontratat me personelin			
Nënshkrimi i kontratave me furnitorët			
Nënshkrimi i kontratave me blerësit			
Të tjera			



VIII. PLANI FINANCIAR

Tabela 1 INVESTIMET NË MAKINERI DHE PAJISJE (NËSE KA)				
Nr.	Emri i makinerisë/pajisjes	Sasia	Çmimi për njësi në Lekë	Kosto Totale në Lekë
1	Makineri dhe Pajisje			
2	Software			
3	Mobilje			
4	Të tjera			
	TOTALI në LEKË			

Tabela 2. PAGAT E PUNONJËSVE

Pozicioni i punës	Nr. i punonjësve	Muaj	Paga mujore	Sigurimet shëndetësore e shoqërore	Totali mujor	Totali vjetor
Menaxheri						
Marketing/Ekonomist						
Financier						
Punëtori i I-rë						
Punëtori i II-të						
TOTALI në LEKE						



Tabela 3. PARASHIKIMET E LIKUIDITETIT

	MUAJT	1	2	2	4	5	6	7	8	9	Totali
A	GJENDJA NE FILLIM										
B	HYRJET NE PARA (1-5)										
1	Të ardhurat nga shitja e produkteve										
2	Hyrje nga debitorët										
3	Kreditë bankare										
4	Kapitali i pronarit										
5	Të ardhura nga granti										
C	DALJET NE PARA GJITHSEJ										
1	Blerja e lëndëve të para/produkteve (variabël)										
2	Qeraja e ndërtesës										
3	Pagat neto të punonjësve										
4	Sigurimet shoq + shëndetësore										
5	Energjia elektrike										
6	Uji +karburant										
7	Telefon +Internet										
8	Materiale zyre /administrative										
9	Reklama /Marketing										
10	Kosto te veprimeve me bankën										
11	Pagesa për mbajtjen e kontabilitetit										
12	Interesi										
13	Pagesat e kredisë										



14	Pagesa pajisje me qira										
15	Pagesa për software										
16	Siguracione makine										
17	Riparime										
18	Udhëtime										
19	Taksat bashkie/akciza										
20	Kosto te tjera										
D.	TEPRICA/ DEFICITI (B-C)										
E.	GJENDJANE FUND TE PERIUDHES (A+B- C)										



TABELA 4: PARASHIKIMI I HUMBJE/ FITIMIT PËR NJË PERIUDHË 3-VJECARE			
Vitet	2024	2025	2026
Shitjet			
Kosto e mallrave të shitura			
Shpenzimet operacionale			
Totali			
Amortizimi nëse ka			
Fitimi para taksave			
Tatimi mbi fitimin 15%			
Fitimi neto			



IX. PLANI I VEPRIMIT

Lutemi jepni përshkrim të detajuar për secilin shpenzim që kërkon të mbulohet nga granti.

	AKTIVITETET	MUAJT									Totali në Lek
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	
1	Qira për ambiente										
2	Makineri, pajisje, software, etj										
3	Blerja fillestare e lëndëve të para ose produkteve										
4	Paga bruto dhe sigurimet e punëdhënësit										
5	Promovimi dhe reklamimi i veprimtarive të biznesit										



Aneksi 8 – Proceverbal i mbylljes së Thirrjes së hapur publike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës

Nr. _____ Prot

Durrës, më _____.2025

PROCES VERBAL

I mbylljes së thirrjes së skemës së grantit

I mbajtur sot më datë _____.2025, në Bashkinë Durrës në mbyllje të procesit të dorëzimit të aplikimeve për thirrjen dedikuar të rinjve të moshës 18-30 vjeç, banues në Bashkinë Durrës të cilët kanë një ide apo kanë një biznes ekzistues të vogël ose të mesëm dhe kërkojnë të shndërrohen në biznese në fushën e mjedisit dhe trashëgimisën kulturore.

Thirrja publike është shpallur me date _____.2025 në:

website të Bashkisë Durrës www.durres.gov.al

Janë të pranishëm nëpunësi i zyrës

Bazuar në Udhëzuesin e Aplikimit të miratuar me VKB nr. date .../.../2025, aplikimet e plotësuara me të gjithë dokumentacionin duhet të dorëzohen personalisht pranë zyrës së Marredhenieve me Publikun, në një zarf që I referohet thirrjes publike, gjatë ditëve të punës.

Afati për dorëzimin e aplikimeve është/.../2025 në orën ____:____.

Sa më sipër grupi i punës mbylli procesin e dorëzimit të aplikimeve me date .../.../2025, në ora ____:____. Numri rendor i aplikimeve të dorëzuara në Bashkinë Durrës deri më date .../.../2025 është _____(.....) aplikime.



Drejtorja e Turizmit do të administrojë dhe do të ruajë dokumentacionin deri në momentin e mbledhjes së Komisionit të Vlerësimit.

Koordinues

Drejtorja e Turizmit

Aneksi 9 – Njoftim për Aplikantët



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

Njoftim për Aplikantët

Nr. _____ Prot

Durrës, më _____.2025

Drejt

I nderuar Z./Znj.

* Kemi kënaqësinë t'iu informojmë se plani i biznesit që keni dorëzuar në Skemën e Granteve të Bashkisë Durrës, ***“Grante për të rinjtë në mbështetje të zhvillimit të iniciativave ekonomike lokale”*** do të financohet me një grant prej LEK.

Ju urojmë shumë suksese në realizimin e idesë tuaj për biznesin. Ju lutem kontaktoni Bashkinë Durrës për më shumë informacione në lidhje me afatin kohor për përfshirjen e biznesit tuaj dhe kushtet dhe afatet për nënshkrimin e kontratës për dhënien e grantit.

** Me keqardhje ju informojmë se aplikimi që keni dorëzuar në Skemën e Granteve të Bashkisë Durrës, ***“Grante për të rinjtë në mbështetje të zhvillimit të iniciativave ekonomike lokale”*** nuk arriti totalin e pikëve minimale të kërkuara, dhe si rrjedhojë nuk jeni pranuar për të marrë grantin për biznesin tuaj.

Komisioni i Vlerësimit e vlerësoi aplikimin tuaj me pike, sipas Udhëzuesit të Aplikimit për zbatimin e skemës të Bashkisë Durrës për “Grante për të rinjtë në mbështetje të zhvillimit të iniciativave ekonomike lokale”, vetëm aplikantët, aplikimi i të cilëve kanë marrë mbi 70 pikë do të pranohen për të marrë financimin dhe fatkeqësisht ju nuk jeni në këtë grup.

Plani juaj i biznesit u vlerësua me pike sipas kriterëve të realizueshmërisë dhe pike sipas kriterëve për prioritet. Komisioni e bazoi vlerësimin te kriteret e mëposhtme:

Kriteret për realizueshmërisë

- Treguesi i qëndrueshmërisë financiare – biznesi vlerësohet si ...
- Treguesi për rezervat në dispozicion - biznesi vlerësohet si ...
- Treguesi i familjarizimit me llojin e biznesit - biznesi vlerësohet si ...
- Treguesi i tregut - biznesi vlerësohet si ...
- Kriteret e prioriteteve – plani juaj i biznesit nuk merr asnjë pike / merr pikë sipas kriterëve të vlerësimit



KRYETAR

Emiriana SAKO

Aneksi 10 - Kontrata për dhënien e grantit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës

Kontrata për dhënien e Grantit

Nr...../...../.....

Sot më/...../..... në qytetin e Durrësit palët nënshkruese

Bashkia Durrës (më poshtë referuar si “Bashkia” si njëra palë INSTITUCIONI FINANCUES dhe

Subjekti perfitues i grantit më poshtë referuar si PËRFITUESI bien dakord si vijon:

1. QËLLIMI I KONTRATËS

- Institucioni Financues akordon dhe përfituesi pranon cmimin e grantit në shumën LEK në kuadrin e skemës së Bashkisë së Durrësit “Grante për të rinjtë në mbështetje të zhvillimit të iniciativave ekonomike lokale”

Granti do të përdoret për këto qëllime:

1.

2.

- Nëse përfituesi përdor grantin për qëllime të tjera dhe jo për biznesin e aprovuar ose nëse ndërpret aktivitetin e biznesit pa ndonjë arsye objektive, institucioni financues do të nderpresë menjëherë financimin dhe do të depozitojë një padi në Gjykatën përkatëse.
- Granti i akorduar jo me shume se 1.000 .000 LEK

TERMAT DHE KUSHTET PËR TRANSFERIMIN E GRANTIT

- Granti do të transferohet në llogarinë bankare të përfituesit sipas detajeve të mëposhtme:
Banka
Llogaria bankare
Kodi bankës



Institucioni financues do të transferojë grantin nëpërmjet sistemit bankar. Bashkia do të kryejë likuidimin e vlerës së kontratës sipas realizimit të aktiviteteve të përcaktuara në projekt, përgjatë të gjithë periudhës së vlefshmërisë së kësaj kontrate nga fondi i parashikuar në buxhetin 2025-2026 të Bashkisë Durrës. Lëvrimi i shumës do të bëhet sipas planit të aktiviteteve. Kusht për lëvrimin e një shume është realizimi i shpenzimeve dhe dorëzimi i dokumentacionit mbështetës narrativ dhe financiar, dhe verifikimi i tij nga Drejtoritë përgjegjëse për shpenzimet që kanë lidhje të drejtpërdrejt me aktivitetet e biznesit sipas pikës 5.1 për periudhën kohore nga nënshkrimi kësaj kontrate deri në përfundim të saj.

- Përfituesi do ta përdorë grantin tërësisht brenda 6-12 muajve nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate
- Përdorimi i plotë i grantit do të verifikohet në një raport mbi përdorimin e fondeve i nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit financues.

TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E PALËVE

- Institucioni financues mund të refuzojë transferimin e grantit nëse përfituesi nuk përmbush detyrimet kontraktore të përcaktuara.
- Në këtë rast kontrata shpallet e pavlefshme automatikisht pa pasur nevojën që të njoftojë paraprakisht palën fajtores.
- Përfaqësuesit e autorizuar të institucionit financues, mundën që në çdo moment të kryejnë vizita në terren për sa i përket progresit të aktiviteteve sipas planit të biznesit, vëzhgimit të aktiviteteve dhe shpenzimeve të programit, organizimit të biznesit, verifikimit objektiv të shpenzimeve, ndikimit nga përdorimi i grantit. Ata gjithashtu mund të kërkojnë dokumentet që mbështesin kostot dhe dokumente të tjera, raportime narrative dhe financiare etj.
- Përfituesi mund të përdorë grantin e dhënë në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës.
- Përfituesi merr përsipër të përdorë fondet e grantit vetëm për qëllimet e specifikuarane paragrafin 2 dhe të realizojë planin e biznesit të bashkëlidhur këtu.
- Përfituesi merr përsipër të ofrojë akses të lirshëm për vizitat në terren për shqyrtimin e dokumenteve mbështetëse të kostove për shpenzimet e fondit të grantit si dhe të japë çdo informacion tjetër në lidhje me ekzekutimin e kontratës.
- Përfituesi merr përsipër të sigurojë të gjitha licencat, lejet, dokumentet e kategorizimit certifikatat e regjistrimit të nevojshme në lidhje me performancën e aktivitetit të përcaktuar në planin e tij të biznesit jo më vonë se
- Përfituesi nuk do të ndryshojë formën ligjore të biznesit të tij dhe nuk do të rregullojë dhe as do të pengojë ndonjë pronë e cila u mor me anë të fondeve të grantit ose që përdoret për zbatimin e planit të biznesit pa marrë leje me shkrim nga institucioni financues.

DISPOZITA TË TJERA

- Nëse ndodh ndonjë shkelje institucioni financues mund t'i japë fund kontratës duke dërguar një njoftim me shkrim 7 ditë para, si rrjedhojë Përfituesi do të jetë përgjegjës për rimbursimin e shumës së plotë të fondeve të grantit të marra brenda 10 (dhjetë) ditëve nga përfundimi i kontratës.
- Kontrata mund të përmirësohet ose zgjerohet vetëm nëse ka miratimin e ndërsjelltë të palëve me shkrim të bashkëngjitur si një aneks këtu. Një aneks i tillë do të bëhet pjesë themelore e kontratës.
- Për çështje që nuk parashikohen në këtë kontratë do të aplikohen dispozitat e legjislacionit civil dhe tregtar shqiptar.
- Cdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kontratës do të zgjidhet me miratimin e ndërsjelltë midis palëve. Nëse nuk arrihet, mosmarrëveshja do të zgjidhet nga Gjykata përkatëse.
- Palët deklarojnë vullnetin e tyre për mirëbesim dhe konfidencialitet në marrëdhëniet e tyre dhe përmbajtja e kontratës nuk duhet të bëhet publike.
- Kontrata do të hyjë në fuqi që prej datës së nënshkrimit dhe do të jetë e vlefshme deri më..... (jo më shumë se 12 muaj).

NË DËSHMI TË KËSAJ palët realizuan këtë kontratë në tre kopje identike- një për secilen palë.



Për Bashkinë Durrës:

Për Përfituesin e Grantit:

Aneksi 11 – Raporti mbi përdorimin e Përkohshëm/Përfundimtar të Grantit për aplikantin



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës

Raporti mbi Përdorimin e Përkohshëm/Përfundimtar të Grantit për aplikantin

Aktivitetet		Shpenzimet në LEK	
E planifikuara	Reale	E planifikuara	Reale
1. Qiraja			
2. Makinerite, pajisjet, software gjithsej			
3. Rezervat fillestare të furnizimeve dhe lendeve të para gjithsej			
4. Pagat dhe sigurimet gjithsej			
5. Promovimi dhe reklamimi i aktiviteteve gjithsej			
TOTALI			



U përgatit nga:

(Përfaqësuesi i biznesit)

U rishikua nga:.....

(Grupi i monitorimit i Bashkisë Durrës)

U konfirmua nga:

(Nëpunësi autorizues)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës

Aneks 12 – Formulari i Monitorimit

Raporti Periodik/Përfundimtar

Periudha e raportimit	NGA (data)	DERI MË (datën)

Emri i organizatës:	
Adresa:	
Telefon:	
Email:	
Personi përgjegjës për aplikuesin:	



Identifikimi i projektit:

Emri i projektit:	
Vendndodhja:	
Fillimi i projektit:	
Përfundimi i projektit:	

Buxheti dhe financat:

Buxheti total (i miratuar)	
Fondet e transferuara deri më tani:	
Kontributi i aplikantit:	

Pyetjet e monitorimit për bizneset që aktualisht po përdorin grantin, por që nuk kanë filluar operimin e biznesit			
A po zhvillohen aktivitetet sipas programit? Ju lutemi përshkruani ndonjë ndryshim të paautorizuar që u bë gjatë vizitës për monitorim:	Po	Jo	Pjesërisht
Koment:			
A janë mjediset e biznesit në dispozicion dhe gati për përdorim? Ju lutem përshkruani gjendjen e mjediseve, lejet përkatëse etj.:	Po	Jo	Pjesërisht
Koment:			
A ka biznesi të gjitha lejet, licensat, patentat, certifikatat, politikat e sigurimeve përkatëse dhe dokumente të tjera në lidhje me performancën e aktiviteteve të biznesit, sic specifikohen në planin e biznesit?	Po	Jo	Pjesërisht
Koment:			
A ka blerë përfituesi i grantit pajisjet e specifikuara në planin e tij/saj të biznesit? Ju lutem përshkruani gjendjen e pajisjeve:	Po	Jo	Pjesërisht
Koment:			
A ka blerë përfituesi i grantit furnizimet dhe lëndët e para të specifikuara në planin e biznesit?	Po	Jo	Pjesërisht
Koment:			
A e filloi biznesi veprimtarinë brenda datës së planifikuar fillestare? Nëse jo, cilat janë disa prej shkaqeve të vonesës, a ka ndonjë kërkesë për shtyrje dhe cila është periudha e shtyrë për nisjen efektive të biznesit?	Po	Jo	Pjesërisht
Koment:			



Pytjet e monitorimit për bizneset që përdorën grantin dhe filluan operimet e biznesit
Si e promovon përfituesi i grantit biznesin e tij/saj? A ka biznesi materiale promocionale ose një faqe interneti: a merr pjesë në panaire, ekspozita për tregun, evente biznesi etj?
Si i shet biznesi produktet/shërbimet e tij? A ka kontrata me klientët? Ju lutemi ofroni detaje.
Si është situata e stafit në biznes – sa punonjës punojnë në biznes, cilat janë aftësitë e tyre, a ka largim stafi, a janë krijuar vende pune të reja?



PËRFUNDIM: Deri më sot, biznesi po arrin/po arrin pjesërisht/nuk po arrin synimet e veta.

REKOMANDIME:

Data:

Përfaqësuesi i Biznesit:

Grupi i Monitorimit:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës

Aneksi 13: Deklarata e Paanshmërisë dhe Konfidencialitetit

DEKLARATA E PAANSHMËRISË DHE KONFIDENCIALITETIT

Unë, I nënshkruari..... (emri dhe mbiemri), anëtar i Komisionit të Vlerësimit për aplikimet për ide biznesi të marra në dorëzim sipas Thirrjes Publike të Bashkisë Durrës në Konkursin e Ideve në fushën e Mjedisit dhe Trashëgimisë Kulturore deklaroj si më poshtë:

DEKLARATË NË LIDHJE ME

(A) KONFLIKTIN E INTERESAVE

Se nuk jam përfshirë në përgatitjen e ndonjë projekt-propozimi që po shqyrtohet nga Komisioni i Vlerësimit dhe se projektet në fjalë nuk kanë lidhje me:

- Interesat e mia personale (financiare ose të tjera)
- Interesat (personale, financiare ose të tjera të ndonjë organizate që unë menaxhoj, në të cilën unë punoj, që unë përfaqësoj ose këshilloj)

(B) KONFIDENCIALITETIN

I gjithë informacioni i përftuar gjatë procesit të vlerësimit të projekt-propozimeve si anëtar i Komisionit të Vlerësimit do të trajtohet rreptësisht në konfidencialitet.

Data:.....2025

Në Bashkinë Durrës

Nënshkrimi:.....



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës

**Aneksi 14: FORMULAR PËR KONFIRMIMIN E MARRJES NË DORËZIM TË
DOKUMENTACIONIT PRANË BASHKISË Durrës**

Marrje në dorëzim të dokumentacionit të projekt propozimit në Përputhje me Thirrjen Publike në Konkursin e Ideve në fushën e Mjedisit dhe Trashëgimisë Kulturore e dorëzuar nga
më ____/____/2025



(Vula)

Marrë në dorëzim nga punonjësi i Bashkisë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës

Ankesi 15: Kërkesë për likuidim

Emri i biznesit



Nr. _____ Prot

Durrës, më / / 2025

Lënda: Kërkesë për Likuidim

Drejtuar: Bashkisë Durrës

Bashkëlidhur po ju dërgojmë dokumentacionin për likuidimin e aktiviteteve të parashikuara në projektin (titulli i projektit) sipas dokumentacionin bashkëlidhur.

Faleminderit për bashkëpunimin!

Sipërmarrësi

.....



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës

Aneksi 16: Deklarata për plotësimin e kriterëve

Emri i biznesit që po zbaton Projektin



DEKLARATA PËR PLOTËSIMIN E KRITEREVE

Unë, i nënshkruari/e nënshkruara

(Emri, mbiemri dhe adresa e aplikantit)

Përfaqësues i/ përfaqësuese e

(Emri dhe adresa e aplikantit)

Konfirmoj se jam përfaqësues i ligjshëm i aplikuesit dhe se unë, i/e sipërshënuar:

- a) Nuk jemi në gjendje falimentimi;
- b) Nuk kemi ndonjë pagesë të bllokuar me vendim gjyqësor, që çon në humbje të plotë ose të pjesshme të së drejtës sonë për të menaxhuar dhe përdorur pronën tonë;
- c) Nuk jemi objekt i ndonjë procedimi ligjor kundër nesh, përfshirë i urdhrave për pezullim të pagesave që mund të çojnë në falimentim dhe që mund të shkaktojnë humbje të plotë ose të pjesshme të së drejtës sonë për të menaxhuar dhe përdorur pronën tonë;
- d) Nuk kemi marrë asnjë vendim fajësie për ndonjë shkelje ose kundërvajtje që lidhet me sjelljen në punë;
- e) Nuk kemi lënë pa përmbushur ndonjë detyrim lidhur me pagimin e sigurimeve shoqërore apo taksave;
- f) Nuk jemi fajtorë për raste të rënda të dhënies së informacionit të rremë për veprimtaritë tona profesionale;

- g) Nuk jemi shpallur fajtorë për shkelje të ndonjë detyrimi kontraktual;
- h) Jam objekt i deklaratës ndihma *De minimis*, në zbatim të ligjit 93473, datë 21.04.2005 “Për ndihmën shtetërore”.

DEKLARATA E BËRË

(vendi, data)

(emri dhe mbiemri, nënshkrimi)

NË PRANI TË:

(vendi, data)

(emri dhe mbiemri, nënshkrimi)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës

Aneks 17 – Lista e Kontrollit

Projekt – Propozimi



- 1.
- 2.
- 3.

Dokumentacioni shtesë

- 1.
- 2.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës



Nr. 798/5 prot.

Durrës, më 14.11.2025

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.66 datë 11.11.2025 ,” Për miratimin e udhëzuesit për mënyrën e aplikimit për implementimin e skemës: Grante për të rinjtë në mbështetje të zhvillimit të iniciativave ekonomike lokale”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
EMILJAN JANI

